

GAZETA "ZËRI I KOSOVËS" DHE ROLI I SAJ PATRIOTIK



Prof.dr.Sabile Keçmezi-Basha

Si vazhdimësi e grupeve të mëhershme ilegale patriotike shqiptare në Kosovë ishte edhe Organizata patriotike ilegale “Grupi Revolucionar”, që u formua në vitin 1972. Në aktgjykimin e anëtarëve të grupit nuk thuhet se me cilën datë është formuar organizata, por, dihet me saktësi se organizata u formua nga patriotët të njohur të jetës ilegale. Po shënojnë renditjen sipas përgjegjësisë dhe në harkun kohor 73-82 të anëtarëve të Komitetit Drejtues të Organizatës. Kadri Osmani (73-74); Mehmet Hajrizi (73-82); Xhafer Shatri (73-74); Binak Ulaj (73-74); Feriz Seferaj (73-74); Gani Sylaj (74-79); Hydajet Hyseni (74-82); Kadri Zeka (75-82); Sherafedin Berisha (75-77); Jakup Krasniqi (80-82); Berat Luzha (80-82); Bejtullah Tahiri (81); Nezir Myrtaj (81-82); Basri Musmurati (81).

Grupi Revolucionar kishte formuar si pjesë të vetën organizative një komitet të studentëve në pranverën e vitit 1974 në përbërje: Xhafer Shatri - përgjegjës, dhe anëtarët Rexhep Malaj (zëvendës), Gani Sylaj, Hydajet Hyseni dhe Ilmi Ramadani.

Grupi Marksist-Leninist i Kosovës (vazhdues i GRK), më 1978 kishte formuar përveç Komitetit Drejtues edhe Komitetin Ekzekutiv në përbërje: Ismail Syla, Jakup Krasniqi, Saime Isufi, Bejtullah Tahiri, Jashar Hajrizi, të gjithë këta me rastin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e shpërndan edhe një trakt.

Organizata e GRK-OMLK është formuar në fillim të viteve 70 dhe ka pushuar veprimtarinë më 1982. Kryetar i saj (1973-74), ka qenë Kadri Osmani dhe pastaj në periudhën 1974-1982 - ka qenë Mehmet Hajrizi.

Disa nga këta edhe më herët kishin qëndruar në burgjet e Serbisë, andaj nuk ishte krejt e rastësishme pse edhe përcilleshin nga njerëzit- hije edhe pas daljes nga burgu. Qëllimi i organizatës ishte që në mënyrë të organizuar të punohej ilegalisht me masat e gjera, për të krijuar në të ardhmen një klimë të përshtatshme në të cilën do të mund të sendërtoheshin synimet shekullore që Kosova dhe pjesët shqiptare nën ish- Jugosllavi të bashkoheshin dhe në një të afërme të shpejtë të bëheshin pjesë e pandashme e shtetit amë- Shqipërisë. Për punë sa më të suksesshme ilegale dhe për të ruajtur konspiracionin e thellë të anëtarëve, udhëheqja e organizatës anëtarëve të vet u caktoi pseudonimet dhe punën e mëtejshme e organizuan në formë të “tresheve“.

Ndërkohë përpiluan dhe shtypën “Paraprojektin” e organizatës ilegale. Në fillim të tij, nën 1, thuhej: “Grupi Revolucionar” është grup paraprijës i Partisë së ardhshme, që do të lindë nga elementet më të shëndosha, të cilat do të jenë pararojë e popullit në luftë për bashkimin e atdheut. “Grupi Revolucionar“ veprimtarinë e vet e orienton drejt zgjerimit të radhëve - si kusht vendimtar për krijimin e partisë pararojë. Në vete do të përfshijë elementet më revolucionare të popullit tonë, të cilat, nën udhëheqjen e kësaj “Partie”, përmes revolucionit të armatosur, do të luftojnë për bashkimin nacional. “ Grupi Revolucionar “ për veprimtarinë e vet është përgjegjës para popullit. Në “ Paraprojekt “ u përfshinë edhe: 1. Anëtarësia dhe marrëdhëniet në “ Grupin Revolucionar “, 2. Të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të grupit, 3. Mënyra e veprimit dhe kushtet për punë në ilegalitet të thellë, 4. Fondi i “Grupit Revolucionar”, 5. Mënyra për përfitimin e anëtarëve të rinj¹ etj.

Në punën e mëtejshme të anëtarëve të organizatës bie në sy sidomos veprimtaria botuese e saj. Duke pasur parasysh rrethanat historike në të cilan vepronin radhët ilegale dhe mungesën e përvojës së shtypit të Lëvizjes Kombëtare të Kosovës së pas LDB, ndërmarrja për një shtyp të tillë ishte sa e vështirë aq edhe e guximshme.² Me potencialin intelektual që kishte, anëtarët e organizatës morën qëndrim që të botonin edhe buletin “Zëri i Kosovës”. Por, për të nxjerr një gazet apo revistë, ato jo vetëm që kërkonin veprimtar të penës, të përgatitur profesionalisht dhe të qartë në dijet teorike, por edhe teknik të shtypjes e bazë për ta strehuar e përdorur sigurt.³ Qysh më 1973, “Grupi Revolucionar” kishte filluar përgatitjet për nxjerrjen e një organi të saj.

Pas shumë diskutimeve në grup, ishte vendosur që organi i organizatës të quhej “Zëri i Kosovës”. Më 1974, grupi ilegal nxori numrin e parë të saj, të pagëzuar me emrin

¹ Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut- Prishtinë, P. nr. 31/ 82

² Mehmet Hajrizi, Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë, 2008, f, 78.

³ Po aty.

“Zëri i Kosovës”, ashtu edhe siç ishin marr vesh. Ilegalistet fillimisht mendonin se kjo gazetë njëherë do të jetë edhe zëri i vërtet i popullit të Kosovës. Gazeta “Zëri i Kosovës”, numri i parë i saj doli me 1 shkurt 1974⁴. Dhe fillimisht kishte 32 faqe, të shtypura në makinë në fletë A-4.

Të gjitha shkrimet që u botuan në këtë gazetën “Zëri i Kosovës” janë të nënshkruara me pseudonime, për hir të konspiracionit. Nëpërmjet shkrimeve që u botonin në të, bëhej apel që populli të mos duronte padrejtësitë e shumta, sulmohej sistemi okupues jugosllav dhe udhëheqësja më e lartë e saj⁵. Në mënyrën më reale paraqiteshin raportet ndërnacionale, zhvishej nga fetishi vëllazërim- bashkimi, i çirrej çdo maskë pushtetarëve si dhe sistemit: në ekonomi, në kulturë, në arsim dhe në shkencë.

Në faqen e parë paraprin thirrja “Popuj të robëruar në gjithë botën, ngrihuni në revolucion!”, po në të njëjtën faqe janë të vizatuara drapri e çekani, emri i gazetës, shqiponja dy krenare, një vizatim i autorit Gani Sylaj, me dy të rinj, njëri me flamurë e një bombë dhe vajza me pushkë në nishan dhe mbi ta fjalia “Liria nuk falet, por fitohet me gjak”.

Shkrimet në revistë fillojnë me editorialin “Fjala hyrëse”, shkruar nga Gjin Dukagjini (Binak Ulaj). Editoriali i revistës përfshinte tri faqe tekst, dhe në të elaboroheshin arsyeja pse u vendos që të dalin me këtë revistë dhe se si ndodhi tradhtia nga ana e Jugosllavisë dhe popullit shqiptar iu mohua çdo e drejt për vetëvendosje duke filluar prej aneksimit të tokave shqiptare. Në të thuhej se “Përmes flakës e tymit të barotit, bijtë shqiptarë duke dhënë jetën në fushën e nderit, vulosën me gjakun e tyre fitoren e lirisë. Pas kësaj ngjarje më të shënuar në historinë e popullit tonë nuk vonoi shumë dhe tradhtia e revizionistëve jugosllav duel në shesh. Gjaku i dëshmorëve të rënë në luftë u shkel në mënyrën më ç’njerëzore. Ideali i përbashkët u tradhtua nga klika titiste. Nën tytën e armëve u vendos “në bazë të vullnetit “ e drejta e vetëvendosjes. Prej asaj kohe, nën parullën e “vëllazërim-bashkimit”, mbi popullin shqiptar në Jugosllavi, u luajt loja e diskriminimit nacional dhe e asimilimit të plotë”⁶. Artikullshkruesi në vazhdim na bënë me dije se shtypi jugosllav në vend që ta informoj opinionin ashtu siç i ka hije, ai boton dezinformata, ”duke e kthyer atë në një armë të rrezikshme në shërbim të klikës në fuqi “.⁷

⁴ Dr. Sabile Keçmezi-Basha, “Gazeta “Zëri i Kosovës” dhe angazhimi i saj për ngritjen e ndërgjegjes dhe unitetit kombëtar”, “Gjurmime albanologjike-seria e shkencave historike”, nr. 35, Prishtinë, 2005.

⁵ Po aty, Aktgjykimi i Hydajet Hysenit, 1982.

⁶ Gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974, f. 2

⁷ Po aty, f. 2.



Kadri Osmani - Kryetar i parë i GRK (1973-74)

Ndërsa, ata që shprehnin haptas qëndrimet e tyre, dhe nuk pajtoheshin me ato që trumbetonte shtypi i vendit “mbylleshin e në disa raste edhe zhdukeshin”⁸. Në shkrim jepen shpjegime se, shtypi në vend që të jetë tribunë e shprehjes së dëshirave dhe shqetësimeve të popullit “shtypi jugosllav shqetësimet e masave i kamuflon me dredhi, ndërsa dëshirat varrosën”⁹. Duke e bërë analizën e informimit në Jugosllavi, autori thotë se “Në kundërshtim me këto receta , lexuesi ynë kërkon të shkruhet qartë dhe me guxim për çdo gjë, të shkruhet me vërtetësi në mënyrë të gjallë, të shkruhet duke qëlluar në shenjë, pa balancim frazash, pa ujë, pa fjalë boshe e frazeologji të thatë”¹⁰. Anëtarët e “Grupit revolucionar” në bazë të shkrimeve vërehen se janë të pakënaqur, me informatat nga fusha e shkencës dhe me faktet historike që iu servohen opinionit. ”Shtypi revizionist

⁸ Po aty.

⁹ Po aty, “Fjala hyrëse “, “Zëri i Kosovës”, nr. 1.

¹⁰ Gazeta “Zëri i Kosovës”, f. 2, 1974.

jugosllav i shtrembëron faktet historike, mohon traditat kombëtare të popullit tonë”.¹¹ “Shtypi jugosllav” për artikullshkruesin është një gabim dhe një mëkat për opinionin ngase nëpër mes tij, e ç’orientojnë rinin tonë të mirë dhe të devotshme, edukimit dhe emancipimit i japin kahe krejt tjetër, ngase ata i kanë llogarit e veta në krejt këtë dhe bëjnë apel se “psikologjia e punëtorit dhe fshatarit janë të ndjeshme ndaj çdo gjëje të huaj, andaj shtypi ynë duhet të përshkohet nga fryma e morali...”.¹²

Ata janë optimist, dhe shpresën më të madhe e kanë tek rinia “ se shumica e rinisë sonë janë të ndërgjegjshëm për detyrat e larta që kanë ndaj atdheut. Për këtë arsye, sado që të na mohojnë lirinë, zjarrin e saj nuk e shuajnë dot nga zemrat tona. Ky zjarr do ti djeg gjithë armiqtë e atdheut tonë, gjithë armiqtë e lirisë sonë.”¹³ Dhe në fund të artikullit thuhej “Populli nuk e ka humbur shpresën dhe as që do ta humbë. Të nisur nga pikësynimi për të kryer sa më me nderë detyrën tonë prej revolucionarësh ndaj atdheut, kemi vendosur për botimin e këtij organi. Përmes tij jemi përpjekë dhe do të përpiqemi t’i përgjigjemi flakë për flakë edhe përmes shtypit luftës sonë të shenjtë për çlirimin tonë kombëtar dhe bashkimit me atdheun tonë të dashur.”¹⁴ Siç shihej edhe nga vet fjala hyrëse, se e tërë kjo edhe ishte qëllimi i botimit të kësaj reviste, ku edhe u apelonte në bashkëpunim nga popullata.

Artikullshkruesit vinin në përfundim se edhe informimi i drejt ishte faktor i rëndësishëm për të përgatitur popullin shqiptar, për të realizuar aspiratat e kahershme për çlirimin e atdheut.

Në katër faqe tekst të revistës, bëhet fjalë kryesisht për “Letrën e Titos” të shkruar nga autori “Selman Karadaku” (Xhafer Shatri), pasi se faqja e pestë në revistë mungon, do ta bëjë prezantimin vetëm të këtyre faqeve që janë gjetur në Arkivin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, në dosjen e të dënuarit politik - Kadri Osmanit. Në vazhdim të shkrimit thuhej se “Letra e Titosë dhe e Byrosë Ekzekutive, është një manifest demagogjik i dorës së parë, pas daljes të së cilës, në mjetet e informimit jugosllav si në radio, në televizion, në shtyp dhe në mbledhje të ndryshme, më fjalët më pompoze flitej për të drejtat që i janë dhënë klasës punëtore, si edhe për vendin e rëndësishëm që duhet të zë ajo në shoqërinë jugosllave, “kritikohen” ata që e kanë shfrytëzuar, bëhen “autokritika” e marrëzira të tjera. Por, a thua vallë, ku na paska qenë gjerë më tani autori i Letrës me gjithë lakejtë e tij?”¹⁵ pyet autori i shkrimit

Pasi se epet një prezantim i situatës në Jugosllavi, autori i shkrimit vije në përfundim se “Letra e Titos” është një lloj riorganizimi dhe mobilizimi i lukunisë së

¹¹ Po aty, Kadri Zeka “ Refleksione”, Gjilan, 2002.

¹² Dr. Sabile Keçmezi- Basha, “Organizatata dhe grupet ilegale në Kosovë 1981- 1989”, Prishtinë, 2003, f. 104.

¹³ Gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974, f. 2.

¹⁴ Gazeta “ Zëri i Kosovës “, “ Fjala hyrëse “, nr. 1. f. 3.

¹⁵ Gazeta “ Zëri i Kosovës “, nr. 1. 1974, “ Letra e Titos “, f. 6.

ujqërve që quhet LKJ, dhe siç po shihet fronti i saj është i hapët. Këtë e vërteton edhe praktika e përditshme kur shqiptaret bëjnë një jetë me të drejta minimale qytetari. Në vend të grabitësve të djersës dhe gjakut të masave punonjëse u burgosën dhe u hodhën nga puna qindra e mijëra kundërshtarë politik. Edhe pse shteti- Jugosllavi me receta të ndryshme u mundonte të dilte nga kriza, megjithatë në batakun që kishte rënë nuk kishte shpëtim, andaj “Kriza e thellë politike, ekonomike dhe shoqërore, që po brente nga themelet regjimi titist, gjendja e rëndë që ekziston sot në Jugosllavi, i ka shtuar edhe më shumë vuajtjet e popujve jugosllav, por në mënyrë të veçantë ajo ka shtuar vuajtjet e mjerimet e popullsisë shqiptare e cila ndodhet nën shtypjen e dyfishtë kapitaliste dhe shoviniste të serbomdhenjëve. Titistët pas Letrës famëkeqe e kanë shtuar edhe më shumë veprimtarin armiqësore antishqiptare”.¹⁶

Në vazhdim thuhej se të gjithë, pa dallim, duhet luftuar politiken destruktive të Titos, ngase “është detyrë e shenjët e popullit shqiptar të Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, veçanërisht e rinisë revolucionare, të cilët gjenden nën zgjedhën e rëndë titiste, të luftojnë për pavarësinë kombëtare dhe për bashkimin e atdheut tonë. Ne, nuk guxojmë t’i harrojmë kurrë të këqijat dhe fatkeqësitë që i ka shkaktuar xhelati Tito popullit tonë, atdheut tonë...”¹⁷ përfundon autori.

Përveç faqeve ku trajtohen problemet politike, në gazetë, anëtarët e grupit ilegal shkruanin edhe për çështje organizative të tyre. Një shkrim të këtij lloji për çështje organizative në faqet e revistës na e sjell autori me pseudonimin “Lekë Kraja” (Mehmet Hajrizi, që shkrimin e vet e kishte rrumbullakuar në tetë faqe tekst. Në pjesën e shkrimit “Puna në celulatat revolucionare dhe zgjerimi i radhëve” prezantohet në pika të shkurtra organizimi i celulave dhe angazhimi i anëtarëve për të zgjeruar radhët e organizatës me anëtarë të rinj. “Aty ku ka shtypje në popull, ka lëvizje për t’iu kundërvënë shtypjes. Këto janë dy forca që veprojnë njëra në tjetrën dhe kjo e fundit gjithmonë fiton”¹⁸, vije në përfundim autori i tekstit. “Duke qenë i tradhtuar dhe i shtypur në mënyrën më të egër nga revizionistët jugosllavë, populli shqiptar nën robërinë jugosllave, është e pamundur të mos lëvizë, të mos luftojë armiqët e tij, nga një anë dhe është e sigurt fitorja e tij në këtë luftë, nga ana tjetër”¹⁹.

Në këtë shkrim njoftohen lexuesit se me luftën ilegale që bëjnë bijtë dhe bijat më të mira të kombit kanë tri qëllime kryesore të cilat janë :1. Çlirimi kombëtar, 2. Çlirimi shoqëror dhe nën 3. që është edhe më e rëndësishmja –Bashkimi me shtetin amë. Dhe vijnë në përfundim se vetëm qëllimi i fundit i jep kuptim të plotë dy të parave. Në

¹⁶ Po aty, f. 7.

¹⁷ Po aty, f. 10.

¹⁸ “Puna në celulatat revolucionare dhe zgjerimi i radhëve”, “Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974, f. 11.

¹⁹ “Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974, f. 12.

nëntitullin tjetër “Celulat revolucionare”²⁰, autori thotë se ato janë shkëndijat të cilat formojnë zjarrin e madh të revolucionit.

Në celulën revolucionare mund të organizohen nga tre-pesë apo më shumë vetë për të punuar sistematikisht në shërbim të çështjes. Nuk është mirë të jetë numri i madh i të angazhuarve në celula, sepse mundë të ndodhë të bije në sy të armikut lehtë. Çdo punë që bëhet në celulë ajo planifikohet dhe studiohet mirë që më parë. Për ti kryer punët si duhet dhe më mirë është e nevojshme, porosit artikullshkruesi, që takimet të caktohen që më parë me aktivistet e celulave. Si përgatitje paraprake për takim (mbledhje të celulës) duhet caktuar koha e sakët dhe vendi ku mbahet takimi. Largësia kohore prej një takimi në tjetrin duhet të jetë më së largu dhjetë gjerë në pesëmbëdhjetë ditë.

Por, thuhej më tej se mbajtja e takimeve mund të rregullohet edhe sipas nevojës. Koha më e përshtatshme për takim mendohej se ishte mbrëmja, duke pasur parasysh se në atë kohë njerëzit vizitohen më shumë në mes veti dhe përcjellja policore evitohet më lehtë. U propozonte që të kihet kujdes edhe vendi se ku mbahen takimet. Duhet siguruar që vendi për takim të jetë shumë i sigurt. Por është e nevojshme që vendet për takime të ndërrohen shpesh. Gjatë takimit çdo anëtarë duhet të jetë i kujdesshëm për punën dhe obligimet që i merr para organizatës dhe anëtarësisë.

Organizimi i punës në mbledhje duhet të bëhet sipas një rendi të caktuar paraprakisht. Kështu e gjithë puna e një mbledhjeje duhet të përmblihet në disa pika kryesore që duhet të trajtohen në mbledhje:

1. Raportimi mbi punën teorike dhe praktike të çdo aktivisti, vështirësitë që ka pasur dhe sukseset që ka arritur nga takimi i fundit gjerë në atë që mbahet. T’i bëhet analizë kritike e gjerë dhe e thellë çdo aksioni praktik. Të mos tolerohen lëshime pa arsye në punën teorike apo praktike, dhe, po ndodhi kjo të merret qëndrim. Përgjegjësia para detyrave duhet të jetë e madhe si në planin personal ashtu edhe në atë kolektiv.

2. Leximi i punimeve me shkrim dhe bisedat rreth tyre. Përveç që duhet caktuar literaturën që duhet ta lexojë çdo aktivist nga takimi, duhet të caktohen edhe tema të ndryshme për të cilat shkruajnë aktivistët e caktuar apo të gjithë. Kështu secili merr një temë për të cilën ka njohuri dhe mund të flasë, e punon me shkrim dhe në mbledhje e lexon para shokëve. Të tjerët, që po ashtu e kanë lexuar materialin për atë temë, japin mendimet e veta, analizojnë mirë punimin që të përvetësohet dhe të mos lëshohet ndonjë gabim. (Kjo metodë pune e sugjeruar këtu, u bë praktikë jo vetëm në këtë, por në gjithë organizatat, por edhe nëpër burgje.) Temat duhet të jenë të natyrës së ndryshme dhe aktuale.

3. Caktimi i detyrave për kohën gjerë në takimin tjetër. Kjo është pika në të cilën ndahen detyrat që duhet të kryejë celula gjerë në takimin tjetër, gjegjësisht detyrat e çdo

²⁰ Celulat revolucionare, “Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974, 13.

aktivisti veç e veç. Për kryerjen e këtyre detyrave të merret vendim. Nuk duhet të lejohet asnjë qëndrim formal ndaj vendimeve. Qëndrimi formal në punën e mbledhjes apo në vendime do të thotë mos përgatitje për mbledhjen. Është detyrë e secilit të mendojë çdo kohë për çështjen dhe në takim të vijë me mendime konkrete, të sakta, i përgatitur, vetëm shumica e përbërjes së celulës mund të marrë vendim. Duhet pasur kujdes që punët të mos monopolizohen vetëm në duart e ndonjërit apo të disave nga pjesëtarët e celulës. Të mos mungojë po ashtu iniciativa dhe guximi që të veprohet. Detyrat duhet të kuptohen drejt nga secili. Është e nevojshme që të organizohet mirë si metodë pune, çështja e kontrollit në zbatimin e vendimeve nga çdo njëri. Ky kontroll duhet të jetë sa rigoroz aq dhe shoqëror dhe ndihmës.

4. Të ndryshme. Kjo do të ishte pika e fundit e mbledhjes në të cilën shqyrtohen problemet e ndryshme. Në këtë pikë caktohet edhe vendi dhe koha në të cilën duhet të mbahet mbledhja e ardhshme. Në fund, gjithë punës së mbledhjes është mirë ti bëhet një rezumë e shkurtër. Mbledhjen e udhëheqë njëri nga shokët, por jo gjithmonë i njëjti, ajo të bëhet me radhë. Që celula të ketë një platformë politike e organizative të shëndosh dhe të jetë në nivel, pjesëtarët e sajë duhet të bëjnë një punë të gjerë teorike e praktike.²¹

Për të vazhduar me tej, se e tërë puna duhet përshkohet nga një vrull revolucionar dhe nga një frymë praktike në veprimtarinë ilegale, ajo vllente si në planin teorik ashtu edhe në atë praktik. Propozonin se duhet ikur nga plogështia dhe të angazhoheshin në gjallërimin e punës për ta mbajtur konstant atë në organizatën ilegale. Nëpër mes shtypit anëtarët e organizatës ilegale parashihnin se “me punën e përditshme dhe sistematike dhe duke e vënë gjoksin pengesave e vështirësive dhe duke i kapërcyer ato me durim, dhe në fund revolucionin i armatosur do ta çojë çështjen tonë drejt në fitore”,²² është për tu admiruar besimi i tyre, në ato vite të rënda robërimi, shpresa e madhe në fitore.

Që të arrihet kjo, thuhej më tej në shkrim, masat e gjëra duhet të kuptojnë drejtë nevojën e lëvizjes dhe të lëvizin në momentin e duhur, prandaj, para anëtarëve të organizatës, si celulë revolucionare, ishte edhe një detyrë e madhe- lidhja e ngushtë me masat. Në revistë këshillohej që masës së gjerë t’iu shpjegohet gjendja në të cilën ndodhet populli, shkaqet e saja, t’ua zbulojmë fytyrën e vërtetë, aq sa ka mundësi, tradhtarëve dhe shfrytëzuesve të popullit duke lënë që nevojën e lëvizjes dhe organizimin ilegal ta kuptojnë ata vet. Të gjitha këto duhet të bëhen më përgatitje solide dhe me mjeshtëri e profesionalizëm. Në raste të këtilla është e mundur që veprimtarët të përcillen nga agjentët ose të qëllonjë aty rastësisht, prandaj kërkohet syçelëti dhe kujdes maksimal nga vetë anëtarët e organizatës.

²¹ Gazeta“ Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974, “ Celulat revolucionare”.

²² Po aty, f. 13.

Kombinimi i punës legale me atë ilegale, si metodë e punës, preferohej më së tepërmi nga Grupi Revolucionar i Kosovës, dhe këtë metodë e propozonin që të zbatohet në celula. Propozonin që anëtarët e “Grupit Revolucionar”, të futen në ndërmarrjet e ndryshme dhe të bashkëpunojnë sa më shumë me punëtorët, me fshatarët, me rininë, me studentët, me intelektualët etj.

Aty ku kishte organizim ilegal, ndikohej që anëtarët e saj të ishin më aktiv. Ndërsa, aty ku nuk kishte veprimtari ilegale, me mençuri depërtonin në ato rrethe dhe ndihmonin që të formoheshin degët, dhe ndikonin që të anëtarësoheshin sa më shumë anëtar. Kështu, me pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të grupit në shumë shoqëri legale të punëtorëve, zejtarëve, studentëve, etj, ndikonin që të ndryshonin lëvizjen e tyre nga ajo spontane në atë të organizuar duke hequr indiferencën politike. “Të marrim pjesë dhe të ndikojmë edhe në grupet e ndryshme letrare, në shtypin legal etj”,²³. Dhe propozonin se ata duhet të ishin gjithmonë kreativë e frymëzues, edukues dhe mobilizues për luftë çlirimtare. Ata ishin shumë të bindur se pa luftë nuk do të ketë zgjidhje të çështjes kombëtare shqiptare. E vërteta e shqiptarëve frymonte gjithkund, se e vërteta e tyre ishte e vërtetë e gjakut, e vërtetë që u dëshmonte nëpër mjet gjakut²⁴ të derdhur me shekuj

Që të kenë lidhje të mira me popullin, propozonin anëtarët e GRK, se duhet të krijojnë celula të reja. Kështu, në ndërmarrje të ndryshme, të punëtorët, duhet të formojnë celula revolucionare të cilat janë si kusht vendimtar për luftën në përgjithësi. Këto celula duhet të kenë interesimin për kushtet e punës të punëtorëve, pagën e tyre, mënyrën e jetesës, mënyrën e shfrytëzimit nga pushteti, ta ngrejë nivelin politik të punëtorëve, të organizojnë në forma të ndryshme të kërkesave të punëtorëve, të organizojnë greva dhe t’iu prijnë atyre etj.

Kritikën dhe autokritikën Këshilli Drejtues propozonte ta kishte si metodë edukimi dhe ngritjeje, dhe të mos i fshihnin gabimet e të metat që u paraqitnin kohë pas kohe, por ti gjejnë shkaqet dhe ti evitojnë ato. Ishin për një transparencë të plotë në mes veti. Të mos ngurrojnë kurrë në kritikën e hapur dhe shoqërore.

Forma kryesore e punës së tyre dhe më e preferuara ishte puna konspirative, prandaj preferonin të mos e lëndojnë e gjymtojnë atë, sepse lëndimi i tyre dëmtonte rëndë celulën, dhe dëmtonte keq çështjen për të cilën ishin angazhuar. Autori propozonte që të ishin konspirativë në çdo punë që bëjnë si ndaj organeve të ndjekjes ashtu edhe ndaj të tjerëve, kur ajo ishte e nevojshme.

U angazhonin që më të madhe të bëjnë organizimin e mirë të punës. Të planifikojnë punën që do ta bëjnë për një vit, për një muaj, për një javë, madje edhe punën e një dite të vetme. Anëtarët e GRK, nga këto të dhëna na del se kishte një

²³ Po aty, f. 14.

²⁴ Ramadan Musliu “ Vetëripërtëritja e totalitarizmit “, Tiranë, 1998.

disiplinë të madhe e rigoroze si në organizim po ashtu edhe në veprimtarinë ilegale. Për celulat propozonin që të kenë plan-programin që duhet shqyrtuar rregullisht dhe vazhdimisht të përmirësohet poçes paraqitet nevoja. Kishin kujdes maksimal që në përcaktimin e detyrave të mos jenë të njëanshme, të kishte detyra si në drejtimin teorik ashtu edhe në atë praktik pa bërë as më të voglin dallim në mes të anëtarëve të grupit. Nga celulat kërkohej që kohë pas kohe të raportohej mbi veprimtarin e anëtarëve të celulës. Në mënyrë të hapur të paraqiten t'metat dhe gabimet eventuale që mund të ndodhin, të zbulohen shkaqet dhe të gjenden mjetet për ti përmirësuar dhe evituar ato.



Mehmet Hajrizi - Kryetar i dytë i GRK - OMLK (1974-1982)

Të bëhet përgjithësimi i eksperiencës dhe të përcaktohen detyrat e reja në mënyrë të barabartë. Këshillonin anëtarësinë që mos të dehen me sukseset dhe të mos dëshpërohen e demoralizohen me disfata. Fitoret i merrnin për bazë që të shërbejnë për suksese të reja, kurse disfatat e humbjet si cytje për të mbledhur e mobilizuar forcat, pa humbur kohë që të kalojnë nga disfata në ofensivë. Nuk duhet humbur kurrë besimin në forcat tona i porositnin anëtarët, se ata ishin optimist duket edhe nga kjo, se në fitoren e tyre ishin shumë të sigurt dhe të bindur.

Gjatë punës ilegale, ilegalja shqiptare preferonte të ishin luftëtar të rrebet, po ashtu edhe armiq të përbetuar të mendjemadhësisë e arbitraritetit, të arrogancës e

gjaknxehtësisë, të subjektivizmit e ambicieve personale, frymës së komandimit e karrierizmit, atribuimit të meritave vetës e hedhjes të tjerëve gabimet e të metat dhe neglizhencës, frymës për tu dukur e frymës së lëkundjes dhe të oportunitizmit, të demoralizimit dhe të mos vendosjes, frymës së përçarjes dhe të çorganizimit e shfaqjeve dhe koncepteve tjera të dëmshme për punën e tyre në celulat revolucionare. Kjo luftë ndaj këtyre dukurive negative zaten edhe ishte e domosdoshme dhe duhej të ishte në rend të parë për të bërë me sukses tjetrën: luftën e hapur kundër armikut.

Pas një pune të gjatë teorike e praktike, anëtarët e organizatës “Grupi Revolucionar” mendonin se celulat e tyre të formuara në formë të “tresheve”²⁵, duhet të fillonin zgjerimin e radhëve të tyre. Dhe mendonin se në këtë mënyrë në organizatën e tyre bënë futjen e gjakut të ri. Nga kjo del se, pjesëtarët e celulës që e bënë këtë aktivitet ishin të aftë të vlerësonin drejtë cilësitë, të mirat dhe të metat e aktivistëve të rinj. Ata ishin njohës të mirë të kriterëve të shëndosha për të kryer këto punë të rëndësishme dhe të madhe. “Nuk duhet pasur nguti në asnjë mënyrë në këtë drejtim që në radhët tona të mund të futen elementet të rastit si dhe njerëzit tjerë që nuk janë për këto radhë sepse forca jonë qëndron në rend të parë në cilësi dhe pastaj në sasi”²⁶, thuhej në shkrimin “Puna në celulat revolucionare dhe zgjerimi i radhëve” shkruar nga “Lekë Kraja” (Mehmet Hajrizi).

Çdo anëtar i ri që hynte në radhët e grupit, ishte e nevojshme që ta kuptonte nevojën e organizimit të lëvizjes dhe ta konsideronte veten si ushtar besnik e i devotshëm në shërbim të popullit gjerë në vdekje. Ata, ishte e preferuar që ta shohin e masin mirë rrugën që ishte shumë e vështirë dhe me plotë pengesa e rreziqe, që kishin përpara dhe të kaliteshin mirë në çdo pikëpamje për ti përballuar të tëra këto me sukses. Ky edhe ishte kushti i dorës së parë, për anëtarin e ri të organizatës. “Çdo njeri prej anëtarëve më të vjetër, por edhe ata që hyjnë të rinj në radhët e organizatës, duhet të jenë në rend të parë nxënës të zellshëm të çështjes kombëtare”²⁷, kërkonte artikullshkruesi. Të jenë pra, revolucionar e patriotë të devotshëm, që nuk njohin kurrë lodhje për çështjen në shërbim të popullit dhe të atdheut. Vetëm njerëzit me cilësi të këtilla mund ti shërbejnë çështjes së pazgjidhur dhe vetëm këta persona mund të jenë në radhët e lëvizjes dhe organizimit ilegal, sugjeronte artikullshkruesi. Zgjerimi i radhëve në organizatë u bënte në atë mënyrë që çdo pjesëtar i celulës formonte nga një celulë të re apo “treshe” siç e quanin ndryshe. Që të ruhej konspiracioni, nuk duhej të njiheshin anëtarët e grupit të njëri tjetrit dhe pjesëtarët e celulës që bëjnë zgjerimin e radhëve. Sipas një rregulle të pa shkruar në organizatë, ata mund të flasin për cilësitë, sjelljet dhe vështirësitë që kishin në punë me

²⁵ Mehmet Hajrizi, Histori e një organizate...vep. e cit., f. 64-65.

²⁶ “Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974, f. 16.

²⁷ “Çështje organizative”, gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974, f. 17.

shokë të rinj, por në mënyrë të përgjithshme pa u treguar shokëve kush janë ata. Kjo edhe ishte parimi kryesor që ishte mase e domosdoshme për funksionimin e grupit ilegal.

Të kërkosh nga të tjerët që t'i njohësh për së afërmi pjesëtarët e celulës së re në të cilën bënë pjesë shoku i yt dhe të bësh atë, sipas shkrimit del se “ta lëndosh haptas konspiracionin”. Kjo ishte edhe dobësia më e madhe që rrezikonte veprimtarin ilegale të vetë organizatës. Qëndrimi bazë i organizatës që vlen të përmendet ishte edhe kjo se ndihma për ti dhënë shokut, sidomos atyre që posa ishin rekrutuar, orientimi dhe udhëzimi i drejt ishte mase i domosdoshëm. Ofrimi i ndihmesë në ngritjen e nivelit teorik, në kapërcimin e pengesave dhe të vështirësive, të kontrollimit në punën dhe për bindjen e tyre për ndreqjen e gabimeve ishte çdoherë i mirëseardhur. Formimi i një numri të madh të celulave, lindi nevojën e një qendre të përbashkët të tyre e cila duhej të koordinonte dhe të drejtojë veprimtarinë e tyre. Kështu lindi nevoja e formimit të “Grupit revolucionar” i cili përbëhej nga përfaqësuesit e celulave në veprim.²⁸ Të tëra këto udhëzime dhe detyra i bënte të njohura për opinionin e gjerë, i bënte personi që vepronte ilegalisht me pseudonimin “Lekë Kraja” (Mehmet Hajrizi). Që për ta zbuluar ishte shumë e vështirë si nga ana e UDB-es, po ashtu edhe nga vetë anëtarët e grupit. Kush qëndronte prapa këtij pseudonimi me gjasë e dinin vetëm një numër i caktuar ilegalësh.

Në një faqe të revistës “Zëri i Kosovës”, që mbante titullin “Plagët tona”, shkrimi me titull “Papunësia dhe kurbeti plagë të rënda në Kosovë” e shkruar nga “Lekë Kraja”(Mehmet Hajrizi), që konstatonte në mënyrë alarmante se “Kosova është rajoni më i pazhvilluar në Jugosllavi. Prapambeturi ekonomike e kësaj krahine ka bërë që popullsia e saj të katandiset në një varfëri të mjerueshme. Lartësia e investimeve dhe tempoja e zhvillimit nuk patën kurrë hapin e viseve tjera të Jugosllavisë, kështu që Kosova ngeli “vendi i zhvilluar midis të pazhvilluarve”²⁹. Papunësia në këtë shkrim paraqitet në bazë të të dhënave statistikore që i prezanton Enti i Statistikës në Serbi (flet autori për vitin 1974, shënim i SK-B), papunësia ka qenë dhe vazhdon të jetë një peshë e rëndë e ekonomisë së kësaj krahine. Sipas të dhënave statistikore, sot, vetëm 7,6% të popullsisë kosovare janë të inkuadruar në punë në sektorin shoqërorë. (Nëse këtë e krahasojmë me republikat tjera të Jugosllavisë, do të kemi: 17,8% në Slloveni, 30% në Maqedoni, 15% në Serbi. Nga kjo që prezanton autori del se shkalla e papunësisë në Kosovë është dy herë e gjysmë më e madhe se mesatarja jugosllave.

Nga numri i madh i të papunëve, okupuesi e kishte të qartë se ky numër i madh paraqet problem politik, social dhe shoqëror për tërë vendin, prandaj në agjendën shtetërore u imponua nevoja që këtë numër duhet zvogëluar. Dhe u gjend zgjidhja, sipas analistit me pseudonim “Lekë Kraja”, “në vitet e 60 filloi në masë dërgimi i fuqisë

²⁸ Enver Topalli “ Një burgje drejtë lirisë”, Zëri, 25 maj 1992; Dr. Sabile Keçmezi- Basha, Organizatat dhe grupet...vep. e cit., Prishtinë, 2003.

²⁹ “ Papunësia dhe kurbeti plagë të rënda në Kosovë “, “ Zëri i Kosovës “, nr. 1. 1974, f. 21.

punëtore nga vendi ynë në shtetet e jashtme, ku ata do ti nënshtroheshin shfrytëzimit të egër të padronëve perëndimor. Në vitin 1964, në botën e jashtme u dërguan 410 (katërqind e dhjetë) punëtorë nga Kosova. Mirëpo, për fat të keq brenda një kohe të shkurtër ky numër i mërgimtarëve tanë në botën e jashtme, pesëfishohet në 2048 veta. Dhe vetëm gjatë viteve 68-69 në vendet e Evropës dërgohen 10.739 punëtor nga Kosova. Në Republikën Federale Gjermane u punësuan 8.442 veta. Papunësia ishte akoma e madhe, ushtria e të papunëve sa vije e shtohet. Andaj, pushteti iu frikonte trazirave sociale në Kosovë, andaj kjo edhe ishte shkaku që u shtua shitja e fuqisë punëtore në vendet perëndimore³⁰. Në shkrim konstatohet se më vitin 1971 në botën e jashtme kishte mbi 24.000 punëtorë kosovar. Në kohën kur u shkrua artikulli, është fillim viti 1974-shit, dhe autori dëfton se në këtë kohë nga Kosova në emigrim (të punësuar në botën e jashtme) ishin mbi 40 mijë punëtor, prej tyre 90% ishin shqiptar, që janë përcjell në mënyrë të organizuar nga entet për inkuadrim, ndërsa shumë punëtor shkojnë në mënyrë stihie, kurse shumë të tjerë nuk kalojnë kufijtë e shtetit, por punojnë në republika të tjera të Jugosllavisë³¹.

Edhe pse rrugët e perëndimit filluan të mbushën me fuqi punëtore shqiptare, prapë se prapë, në Kosovë papunësia shtohet, kështu në bazë të analizës që na e prezanton “Lekë Kraja” (Mehmet Hajrizi), thuhej se “ Në Entet për Inkuadrim kërkojnë punë përmbi 37.000 vetë (85% e të cilëve nuk kanë kurrfarë kualifikimi). Sipas statistikës, Kosova ka 45.000 banorë aktivë, kurse rezervat e fuqisë punëtore arrijnë në 15.000 veta. Dhe nga kjo që u tha më lartë vijmë në përfundim se këto janë fakte shqetësuese të gjendjes ekonomike të punëtorit tanë, të jetës së tij të mjerë. Edhe më e keqe, më e mjerueshme ishte gjendja e punëtorit të punësuar në sektorin privat. Shumica e këtyre punëtorëve punojnë më gjatë se që është orari i caktuar, e puna e tillë nuk trajtohet si e zgjatur. Këta punëtor, pastaj nuk i gëzojnë as të drejtat e sigurimit social e as të drejtën e njohjes së punës së tyre në stazhin për pension.”³² Dhe, thjesht thënë punëtorët e pa punë kishin ngelur në mëshirën e fatit. “Kosova kishte kurbetçinj gati në të gjitha shtetet perëndimore”, konstaton autori. Nga numri i përgjithshëm i të inkuadruarve në punë, në vitin 1970, në botën e jashtme të punëtorëve kosovar, ishin 7,8% nga territori i

³⁰ Po aty, f. 28, “ Letër Kryesisë së RSFJ-së”, dërguar nga të burgosurit politik: Hydajet Hyseni, Zijah Shemsiu, Bajram Kosumi, Ali Lajqi dhe Gani Koci më 8 mars 1985. Sipas të dhënave që kemi, pa kaluar shumë ditë, pas dorëzimit të “ Letrës...” bëhet shpërndarja e të burgosurve politikë, të cilët ishin nënshkrues të kësaj letre- nëpër burgjet tjera të Serbisë. Dy nga ata i transferojnë në Nish, një në Zajeçar, një në Pozharevc, dhe të pestin, Zija Shemsiun, e mbajtën në Beograd. Më se një muaj rresht, UDB-eja përdori mjetet dhe metodat më shtazarake ndaj të burgosurve shqiptar, nënshkrues të kësaj letre, por sidomos ndaj Zija Shemsiut, të cilin edhe e likuidoi fizikisht më 1 maj 1985.

³¹ Po aty, f. 27.

³² Po aty, f. 28.

Prishtinës, 8,7% nga Mitrovica, nga Prizreni ishin 13,5%, nga Gjakova 15,4%, nga Peja 15,8%, nga Ferizaj 12,4%, dhe nga Gjilani ishin 26,4%.”³³

Punëtorët që shkonin në punë, në botën e jashtme, pas vetës, në atdhe linin familjet e tyre me shumë anëtarë, të cilët me pagat e tyre duhej ti mbanin.” Gjatë tetë muajve të vitit 1970, nga territori i Pejës shkuan në punë në botën e jashtme 1.140 veta. Nga këta 1.063 ishin të martuar dhe prej këtyre, 146 nuk kanë pasur fëmijë. Nga një fëmijë e kanë pasur 189 veta, nga dy fëmijë, kanë pasur 193 veta, nga tre fëmijë i kanë pasur 173 veta, nga katër fëmijë - 122 veta, nga pesë fëmijë-111 veta, nga gjashtë fëmijë - 64 veta, nga shtatë e më shumë fëmijë - 66 veta. Këtu duhet llogaritur edhe prindërit, vëllezërit, motrat e farefisnin tjetër që e mbajnë shumica prej tyre. Shqetësohej autori me plotë arsye, ngase fshatrat e Kosovës filluan të zbrazën e të shkretohen, duke i grabitur kurbeti familjet e tëra. Dhe ndodhte shpesh që familje të tëra ia kthejnë shpinën Kosovës duke ikur përgjithmonë nga këtu.”³⁴ . Në shkrim epen të dhëna se çfarë punëtorësh pranonte perëndimi:

1. Në rendë të parë ata duhet të jenë të shëndosh fizikisht dhe psiqikisht. Bile ata ishin shumë rigoroz kur bëjnë kontrollimin e punëtorëve tanë, e sidomos ishin shumë të ashpër kur ishin në pyetje aspekti fizikë e psikik i punëtorit.

2. Punëtorët duhet ti përkisnin moshës 20-35 vjeçare, kur ata jepnin edhe kontributin më të madhe prej punëtorit.

3. Ishte e obligueshme që ata duhet të kryenin ndonjë kurs, së paku për të ditur ti kryejnë punët mirë dhe shpejt. Këto që u cekën më lartë janë kushtet elementare të cilat duhet plotësuar njerëzit tanë, ndërsa për pasoja të mos flasim. Nga e tërë kjo që thuhej autori arrin që pasojat nga kjo, ti klasifikojë në pesë pika:

E para, ata janë të shitur nga vet ana e shtetit te kapitalisti. Shfrytëzimi që bënë ai për të nxjerr profitin dihet fortë mirë, prandaj as që do koment kjo çështje. Megjithatë, këtu janë dy çështje të rëndësishme: Njëra është që punëtorët tanë kryejnë punët më të vështira në këto vende duke u ushqyer shumë dobët nga një anë, dhe nga ana tjetër duke pasur strehimin shumë të dobët në baraka dhe dhoma shumë të vogla e të ndyra, ku mungojnë kushtet minimale higjienike.

E dyta, mosnjohja e dispozitave të ndryshme në vendet ku punojnë dhe mosnjohja e gjuhës së atij vendi, sjellin dëme dhe humbje të shumëfishta te punëtorët tanë jashtë vendit. Kështu, këta punojnë jashtë orarit të punës - kohë kjo për të cilën ata paguhen shumë pakë, apo nuk paguhen fare. U merren tatime të ndryshme dhe nuk shfrytëzojnë në të shumtën e rasteve edhe ato benefite që u takojnë, duke mos ditur se a kanë të drejtë apo jo, etj.

³³ Po aty, f. 29.

³⁴ Po aty, f. 30.

E treta, ata i ekspozohen shpeshherë politikës reaksionare të emigrantëve politik, dhe kështu shndërrohen në vegla qorre të ndikimeve të ndryshme politike nga ana e shtetit- Jugosllavi. Jo rrallë, edhe nën presionin e dhunës së agjentëve që depërtojnë në perëndim, pranojnë të bashkëpunojnë me ta.

E katërta, si u tha edhe më lartë, punëtorët e inkuadruar në botën e jashtme, janë kryesisht të rinj që kryesisht i përkasin moshës 20-35 vjeçare. Pjesa dërmuese e këtyre të rinjve janë fshatarë që s'kanë të mbaruar as shkollën fillore. Kështu , pjesa dërmuese e këtyre të rinjve shfaqin ambicie e lakmi të ndryshme për jetën e perëndimit. Bile, disa nga ata, kthehen në propagandues të rrezikshme të kulturës së prishur.

E pesta, fëmijët e këtyre punëtorëve që kanë shkuar bashkë me familjet në kurbet, ndërprejnë shkollimin për të mos e vazhduar më, ose nuk shkollohen fare. Mësimi plotësues është organizuar vetëm në katër-pesë shtete siç janë: Gjermania, Franca, Zvicra, Suedia dhe Belgjika.³⁵

Veç problemeve tematike që shqyrtohen në këtë numër, në këtë revistë jepen edhe vështrime e recensione të ndryshme për librat e caktuar.

Në faqen e 19, të revistës bëhet vlerësimi i librit “Shqipnia e sotme” nga M. Miliq, që e kishte botuar sipërmarrja gazetare-botuese “Rilindja” më 1962. Shkrimi ishte i hartuar nga autori “Bashkim Gollaku” (Kadri Osmani). Pas një debati që bënte autori në këtë vështrim , ai bënte prezantimin e disa të dhënave për shkollimin e femrave në RP të Shqipërisë : “Në ditët e para pas çlirimit të vendit 94% e grave ishin analfabete, sot jo vetëm nuk bëhet fjalë për gra analfabete, por luftohet për marrjen e arsimit 8 vjeçar, të mesëm dhe të lartë. Bijat dhe shoqet e atyre ish analfabeteve janë sot më shumë se 2500 gra dhe vajza që kanë marrë mësim të lartë. Janë arsimtare dhe inxhinierë, mjekë dhe agronome të Shqipërisë. Pa llogaritur gratë dhe vajzat që ndjekin shkollat me shkëputje, në shkollat pa shkëputje nga puna sot mësojnë rreth 50.000 gra. Universiteti Shtetëror i Tiranës dhe degët e tij numërojnë 5.677 gra e vajza që ndjekin studimet e larta pa shkëputje nga puna”³⁶ na bënë me dije autori i shkrimit..

Ndërsa për ndihmën që i ep PKJ-ja formimit të PKSH-së, autori thotë se “Në të vërtetë ata: Velimir Stojniqi, Petar Bullatoviqi, Dushan Mugosha, Bllazho Jovanoviqi, Svetozar Vukmanoviq- Tempo etj “kontribuan” aq sa u shkoi dore që Shqipërinë ta bëjnë republikë të shtatë të Jugosllavisë. Por, ata ia arritën të përvetësonin vetëm Koçi Xoxën me ndonjë tradhtar tjetër, që të gjithë s bashku morën grushtin dërmues...”³⁷, përfundon autori i shkrimit.

Në disa faqe të revistës rëndësi e veçan i jepet edhe vjershave që janë të shkruara nga autor me pseudonime të ndryshme. Vlen të përmendën poezitë, siç janë: “Heronjtë e

³⁵ “ Plagët tona”, gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974.

³⁶ “Shqipnia e sotme”, gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974.

³⁷ Po aty.

Qelisë” (Shokëve që dergjen burgjeve jugosllave), me autor “Selman Karadakun” (Xhafer Shatri). Vjersha iu kushtohet të burgosurve që kohën më të mirë të jetës e kalojnë në biruca të arrta, të ftohta, të mbërthyer me grila, të burgjeve jugosllave dhe veç të ftohtit e ankthit, asgjë tjetër nuk ka në to. Por, autori këndon se mbi të gjitha është ideali i tyre, dashuria ndaj atdheut dhe ndaj lirisë të cilën asnjëherë nuk e shijuan: “Gjakun tuaj plotë dëlirësi/ po e shkruani fjalën e madhe - LIRI”, për të vazhduar më tej se: “ndaj prangat e grilat e metalta / natën e errët e njerëzit e zi / muret e mëdha e qelitë e ftohta/ ne s’ bashku do t’i thyejmë shpejtë / do sendërtojmë idealet tona të larta!”³⁸, përfundon duke dhënë kushtrimin se qëllimi i tyre do të realizohet herdokur.


Në vjershën “Festa e kuqe” “Bashkim Gollaku” (Kadri Osmani), autori i këndon lirisë, luftës dhe fitores për të cilën supozon se nuk është shumë larg dhe së shpejti do ta shijojmë: “O festa e kuqe që na erdhe në prag, / Dhe gjakun e ngrirë ndër dej për ta shkri, / Na bëre vigjilentë të shohim më larg,/Ta ndejmë afshin e ngrohtë të fjalës-Liri”, për të vazhduar më tej:” Ti- ngrite lart e më lartë kazmën e pushkën/ Se luftën e kem basë për traditë/ Gjyshërit na e lanë trashëgim-hutën/ Qëlloje në ballë armikun në pritë”³⁹. “Bashkim Gollaku” i këndon edhe kohës se si kemi qenë të hutuar dhe nuk kemi pasur shpresa, por dielli që ka filluar të ngrohë papritmas e ka grisë cipën e hollë në sy, dhe tani shohim e dimë qartë se si fitohet liria.

“Fitim Drenica” (Feriz Seferaj), në këtë numër na prezantohet me vjershën “Betimi” e cila është i ndarë në katër pjesë, në të cilën përfshin ngritjen e njeriut luftëtar, që flijohet për atdheun dhe për lirin e tij: “Edhe nëse nëntëdhjetë e nëntë herë rrezohem për tokë/ Të një qindtën herë do ta puthë këtë mu në ballë/ Edhe nëse nëntëdhjetë e nëntë herë do të vdes/ Atdheun tim për kocka nuk e shes”.⁴⁰ Nëpër mes këtyre vargjeve autori e mallkon tradhtarin e sahanlëpirësin, ku thotë se edhe me mija herë do të lind megjithatë jeta asnjëherë nuk do ti dhimbsej për tu sakrifikuar për atdheun, dhe përsëri do ta falë jetën.

³⁸ “ Heronjtë e Qelisë”, gazeta “ Zëri i Kosovës “, nr. 1. 1974.

³⁹ “ Festa e kuqe”, gazeta “ Zëri i Kosovës “, nr. 1. 1974.

⁴⁰ “ Betimi “, gazeta “ Zëri i Kosovës “, nr. 1. 1974.



Revista numër I, “Zëri i Kosovës” përmbillet me poezinë e “Bashkim Gollakut” (Kadri Osmani), që e kishte titulluar “Fitorja jonë”, edhe kjo, si vjersha e më parme është e ndarë në tetë strofë, dhe secila prej këtyre pjesëve fletë për fatin e popullit, sakrificat e tij, dashurin për atdheun dhe luftën e pandërprerë për lirinë. Fletë për stoicizmin, guximin dhe krenarinë e popullit të robëruar, dhe në fund porosit : “Edhe nëntëdhjetë e nëntë herë të na zhdugin/ do të luftojmë!/O, edhe nëntëdhjetë nëntë herë të na korrin/ Do të fitojmë”.⁴¹

Revista “Zëri i Kosovës”, është njëra ndër revistat që në faqet e saja vend meritor i dha dhe i kushtoi situatës politike e shoqërore në vend, por nuk mbesin anash as trajtimet për problemet e arsimit, të kulturës, të shëndetësisë, të administratës dhe të jetës së rëndë e të përditshme të shqiptarëve që kishin ngelur nën okupim. Për këtë tematikë e problematik, si dhe për organizimin profesional të artikullshkruesve, të shkruar në të 32 (tridhjetë e dy faqet) e kësaj gazete dëshmojnë ndër të tjera, edhe rubrikat e përhershme e të përkohshme si: “Fjala hyrëse”, “Çështje organizative”, “Plagët tona”, “Këndi i

⁴¹ “Fitorja e jonë”, gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 1. 1974.

poezisë” dhe “ Vështrime” për librat e ndryshëm që botoheshin në atë kohë. Autorët që shkruanin për revistën, kryesisht ishin njerëz që drejtonin gazetën dhe në tërë shkrimet që prezantohen, në fund të tyre mungojnë emrat e plotë të tyre.

Shkrimet kryesisht janë dhënë me pseudonime si “Gjin Dukagjini” (Binak Ulaj), “Selman Karadaku” (Xhafer Shatri), “Lekë Kraja” (Mehmet Hajrizi), “Bashkim Gollaku” (Kadri Osmani), “Fitim Drenica” (Feriz Seferaj) etj që sot kemi arritur ti identifikojmë. Gazeta “ Zëri i Kosovës” nuk u pajtua kurrë me padrejtësinë e madhe që i bënë kombit shqiptar Fuqitë e Mëdha të Evropës, që e copëtuan atë duke kënaqur lakmitë e qeverive shoviniste të vendeve fqinje. Kjo gazetë gjatë daljes së vet u angazhua për bashkimin luftarak të shqiptarëve, duke popullarizuar e përkrahur frymën atdhetare e nacionaliste të të parëve tanë, dhe në shkrimet që prezantohen në këtë numër, qartë shihet dhe sugjerohet se me armikun e okupuesin duhet një organizim i mirëfilltë për t’i treguar se nuk durojmë dot okupimin. Dhe me rastin e kësaj reviste, karakteri dhe orientimi i saj shprehet edhe me vetë emërtimin e saj “ Zëri i Kosovës “ dhe me vetë maksimën (moto) që i prinë “ Liria nuk falet, por fitohet me gjak “, që ishte sentencë aktuale për kohën dhe rrethanat që ndodhej Kosova.

Vazhdon traditën gazeta “Zëri i Kosovës” , nr 2 .

Në prill të vitit 1974, doli numri i dytë i revistës “Zëri i Kosovës”. Numri i dytë, sikurse edhe numri i parë, në ballin ka një vizatim të Gani Sylajt (një kolonë luftëtarësh, të armatosur, me flamur duke marshuar). Moto e revistës është përsëri “Popuj të robëruar në të gjithë botën , ngituni në revolucion”, dhe në vizatim ishte e shkruar motoja “Liria nuk falet por fitohet me gjak”. Numri II, i revistës është më voluminoz se i pari, ngase ka 42 faqe tekst, ku trajtohen tema të ndryshme duke filluar që nga politika, ekonomia, arsimit, kultura dhe ka një mori poezish patriotike, që i shkruajnë ilegalistët me pseudonime të ndryshme.

Revista hapet me “Këndin e poezisë”, ku botohej poezia e autorit me pseudonimin “Hysë Dervenit” (Hydajet Hyseni)- “Kushtrimi i Kosovës”, ku në rreshta të shkurtër na prezantohet historia e lavdishme e Kosovës, robëria e saj ndër shekuj, luftërat e saja heroike, trimëritë e shumta, bujaria që ishte virtyte tradicional i shqiptarëve, krenaria dhe gjakimi shekullor për liri dhe unitet shqiptar. Autori i këndon me dashuri të madhe djepit të shqiptarisë dhe aludon se djepi i saj është trimëresha Kosovë. I këndon Kosovës kreshnike, Kosovës heroike, Kosovës malore, Kosovës madhështore dhe në vargje e shprehë në këtë mënyrë: “Kosovë, o vatër e trimërisë/ Kosovë o zemër e burrërisë/ Kosovë martire o Kosovë bujare/ Kosovë e jona o Lokja shqiptare/ Ngrihu lart dhe kërko dritë/ Ngrihu e lufto si e ke traditë”⁴². Autori në pamundësi për të ndryshuar gjendjen e

⁴² “ Kushtrimi i Kosovës”, gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 2, prill, 1974, f. 2.

robërisë që kishte katandisur vendin, apelon te të gjithë, pa dallim moshe e feje, që të gjithë të ngritën dhe të luftojnë për lirinë që e gjakuam me shekuj.

1. Trajtimi i çështjeve politike

Trajtimi i situatës politike edhe në këtë numër zë një vend të rëndësishëm. Andaj “Kushtetuta dhe realiteti “ janë temë trajtimi në shkrimin e “Selman Karadakut” (Xhafer Shatri). Autori i këtij shkrimi thotë se: ”Është natyrë e çdo shtypësi dhe pushtuesi që ti ndërrojë dhe perfeksionojë mjetet dhe metodat e tij të shtypjes. Dhe ai këtë nuk e bënë nga dëshira, por vetëm e vetëm që ta zgjasë edhe ndonjë ditë jetën e tij prej padroni. Aktiviteti i okupuesit manifestohet në shumë drejtime, si në vend ashtu edhe në arenën ndërkombëtare. Kështu loja e fundit, (kuptohet gjatë vitit 1974), po luhet edhe me ndërrime kushtetuese”⁴³ e cila sipas tyre na qenka nga më të përkryerat që ka pasur ndonjëherë njerëzimi! Se ajo na qenka “kushtetuta e parë punëtore” dhe “Kushtetuta e vetme ku vie në shprehje barazia dhe aspiratat e popullit”. Autori shprehet se edhe kushtetuta e më parme nuk ka qenë e keqe, por shtrohet pyetja sa u realizua ajo në praktik. “Sipas kushtetutës në fjalë, çdo qytetar ka pas të drejtë të shkollimit dhe inkuadrimin në vend. Por ne e dimë mirëfilli gjendjen e analfabetizmit dhe të papunësisë”. Për të vazhduar më tutje se “Nuk ka ligj në botë që thotë se njeriu duhet të vuaj nga uria. Por, pas neneve të ligjit fshihet dora gjakatare që vret e pret. Pas neneve të kushtetutës jugosllave fshihet regjimi policor titist. Fshihet pushteti i pakufizuar dhe absolut i ministrave dhe i drejtorëve... Cilat na qenkan aspiratat e popullit : vuajtja nën thundrën e borgjezisë jugosllave ? Dergjja nëpër burgjet famëkeqe jugosllave? Degjenerimi i rinisë dhe ç’thurja e saj totale...?”⁴⁴ thotë autori.

Por tani, ai (autori) beson se populli më nuk dot mashtrohet, do të vërej dredhitë që i bënë pushteti gjëja se po sjellin një kushtetutë ku çdo kush do t’i gëzojë të drejtat e barabarta bile- bile, gati Kosova do të shpallej Republikë, por nuk do ta ketë vetëm emrin. Dhe gjuha e fakteve, e formulave është më e rëndësishme dhe më e fuqishme se gjuha e tulit. Andaj ne në vazhdimësi e kemi pësuar se kemi besuar së tepërmi në fjalë e jo në letra. Andaj “Populli i ynë liridashës i ka mprehë shqisat mirë e mirë. Ai do t’i veshë edhe njëherë rrobat luftarake dhe përmes perdes së zezë kushtetutare do t’i qëllojë lugetërit mu në lule të ballit duke marshuar ngadhënjimtarë”⁴⁵. Me këtë shkrim autori mendohej të grisë maskën e okupuesit me gjuhën e fakteve. Populli këtë gjuhë e kuptonte dhe qartë e bindshëm i pranonte mesazhet që i dërgonin veprimtarët e ilegales shqiptare.

2. Trajtimi i çështjeve organizative

Çështjet organizative, në faqet e gazetës zinin vend të veçan. Në gazetë jepeshin udhëzime, këshilla, propozime se si duhet të veprohet dhe se si duhet organizuar e

⁴³ “ Kushtetuta dhe realiteti”, gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f .3.

⁴⁴ “ Këndi politik “, gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f. 3.

⁴⁵ Po aty.

vepruar në kushtet e jashtëzakonshme në ilegalitet. Anëtarët e grupit revolucionar këshillohen se si duhet të bëjnë agjitacion dhe propagandë. Në shkrimin “Çështje agjitacioni dhe propagandë”, autori “Lekë Kraja” (Mehmet Hajrizi), në pesë faqe tekst, prezantonte punën e agjitacionit dhe propagandës në grupe dhe në masë. “Lëvizja revolucionare” thotë autori, “se në Kosovë mund të themi se e hedhë hapin e parë të saj, d.m.th. organizimin e disa aktivistëve për t’i shërbyer me gjithë forcat e tyre çështjes së popullit dhe të atdheut. Dhe nëse kësaj i themi hapi i parë, andaj i dyti me siguri do të jetë zgjerimi dhe intensifikimi i veprimtarisë sonë. Nuk do të ndalim punën në çdo drejtim dhe të shfrytëzojmë të gjitha mjetet për të arritur suksesin e merituar”. Ai thotë se “me këtë nuk dot ngushtojmë radhët, por edhe më tej do ti zgjerojmë dhe kjo do të ngel si detyrë e jona e vazhdueshme”,⁴⁶.

Detyrë e parë ishte përfshirja e gjëra dhe lidhja e pazgjidhshme me popullin, ndërsa për aktivizimin në agjitacion e propagandë do të jenë detyra primare për anëtarët e organizatës, dhe do të jenë të pashmangshme për veprimtarin e zhvillimin sa më të suksesshëm për punën në organizatë.

Nëse organizohet mirë agjitacioni dhe propaganda me popullin, mendon autori i shkrimit, ata do të jenë një ndihmesë e madhe për lëvizjen e gjerë e të organizuar që zhvillohet në gjirin e popullit, nga njëra anë, dhe do të kontribuojnë shumë në ngritjen e tyre politike..

Në të njëjtën kohë do të forcohej akoma më shumë lidhja në mes të lëvizjes legale dhe popullit në përgjithësi. Kjo ishte edhe, një qëndrimi i patjetërsueshëm, ngase lufta e tyre nuk kishte karakter komploti, por ishte luftë e përgjithshme popullore. Ishte luftë për çlirimin e popullit e këtë mund ta bëjë dhe ta realizojë vetëm populli liridashës. Por, që të ngritët gjithë ajo forcë e popullit kundër regjimit okupues, ai pos tjerash, duhet edhe të mobilizohet politikisht, të parapërgatitët dhe të organizohet.

Duhet të bëhet punë politike, e kjo bëhej vetëm nëpër mes të agjitacionit dhe propagandës. “Poqese ne, nuk punojmë me masat, nuk lidhemi me ta, nuk vejmë kontakte të drejtpërdrejta, ata do të mbesin neutral, kështu propaganda e armikut gjënë një trup me imunitet të dobët dhe hynë (së paku në një pjesë të tij), me gjithë helmin e saj në të, kurse ne mbetemi një grusht njerëzish të destinuar për dështim”⁴⁷ mendonte autori “Lekë Kraja” (Mehmet Hajrizi).

“Është populli që paraqet forcën vendimtare në luftë për çlirimin e tij”⁴⁸, konkludon autori i shkrimit. Ishte ilegalja ajo që kishte marrë përsipër që me urtësi të bëjnë mobilizimin dhe përgatitjet e tij, të bëjnë agjitacionin dhe propagandë të pareshtur dhe të organizojnë me mjeshtëri këtë forcë në luftën e armatosur që e priste.

⁴⁶ “Çështje agjitacioni dhe propaganda”, gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f. 4.

⁴⁷ “Çështje organizative”, gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f. 5.

⁴⁸ Po aty.

Anëtarët e organizatës zhvillojnë një propagandë të gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse si në mes të anëtarësisë së vet, njashtu edhe me masat e gjëra popullore. Propaganda bëhet në atë drejtim që preknin të gjitha çështjet më të rëndësishme që sqaronin bindshëm problemet e ndryshme.

Në vijim të shkrimit jepen se çfarë duhet të jetë dhe të punojë propaganduesi dhe agjitor, dhe se si duhet të bëhet propaganda dhe agjitacioni i mirëfilltë. Për çdo agjitor propozohet të jetë i përgatitur dhe i ngritur në aspektin teorik. Propozonin që të angazhohen që të gjithë në sigurimin e teksteve të nevojshme për ngritjen politike të anëtarëve, dhe ato materiale tu shpërndahen shokëve të cilët kishin besim, bashkë me materialet dhe literaturën tjetër konspirative që më vonë në to të punohet seriozisht në përvetësimin e tyre. Të përcillet situata politike e ekonomike në vend e në botë, të njihen detajisht me shtypjen e egër që i bëhet popullit tonë në çdo fushë të jetës, të studiojnë të gjitha shkaqet e kësaj shtypjeje, t'i njohin luftërat e popujve të shtypur, makinacionet që kurdisin kundër tyre, të njihen me sukseset e këtyre luftërave dhe në fund të gjitha këto jenë kusht i domosdoshëm për një agjitor dhe propagandues të mirë për çështjen dhe qëllimin e popullit shqiptar.

Në pamundësi që organi “Zëri i Kosovës”, të shpërndahet lirshëm në popull, kjo gazetë fillimisht iu shpërndante vetëm aktivistëve të lëvizjes. Mirëpo, me përmirësimin e punës në radhët e organizatës, u krijuan mundësi të reja që të zgjerohet dhe të thellohet vetë përmbajtja e propagandës dhe agjitacionit në rend të parë brenda radhëve të ilegales. Autori i shkrimit llogariste shumë në ndikimin e madh që do të ketë kjo revistë si të anëtarët e organizatës, njashtu edhe tek të tjerët që do iu bie në dorë. Revista thuhet në tekst “do të bëjë përpjekje që të sqarojë sa më shumë çështje, që të ndihmojë pjesëtarët e radhëve tona në pajisjen e tyre me një kulturë të gjithanshme dhe në edukimin ideo-politik të tyre. Organi do të sqarojë gjithashtu edhe shumë çështje organizative. Kjo do të bëhet akoma edhe më e rëndësishme dhe nevoja e propagandimit të parimeve dhe të metodave të organizimit, të disiplinës dhe të teknikës konspirative del në plan të parë kur organet policore vihen me gjithë forcat e tyre për të na ndjekur dhe persekutuar”⁴⁹, thoshte autori.

Në shkrim u propozonte që secili anëtar fillimisht të propagandojë ndër shokët e vet, sidomos te ata, të sapo rekrutuarit në radhët e organizatës. U propozonte që më të madhe të propagandojnë idenë e nevojës së domosdoshme të një organizimi më të rreptë në vetë organizatën dhe propozonin që të propagandonin gjithashtu edhe qëndrimin burrëror të tyre përpara organeve hetuese të armikut dhe gjyqit si dhe sukseset e të tjerëve etj, por gjithnjë duke pasur parasysh kriteret e konspiracionit. Popullatës së gjerë në aspektin e propagandës dhe të agjitacionit artikullshkruesi i kushtonte vëmendje të

⁴⁹ “Zëri i Kosovës” nr. 2, 1974, f. 6.

posaçme. Propozohet që në popull të zhvillohet propagandë sistematike në çdo pjesë të vendit.. Puna e parë e ilegales ishte e dëshirueshme dhe e preferueshme që të zhvillohej në rendë të parë me punëtorët dhe rininë studentore. Është e ditur se punëtorët e studentët janë pjesa më e ndërgjegjshme dhe më e shtypur e shoqërisë si në aspektin politik njashtu edhe në atë ekonomik. Kushtet e punës e të jetës së tyre ishin të mjerueshme, të drejtat e tyre ishin të mohuara edhe si komb edhe si klasë.

Pakënaqësia e shqiptarëve ishte e madhe, por vazhdimisht u heshtte nga organet përkatëse. Ata ishin të pa organizuar në aspektin ilegal dhe vazhdimisht e shfaqnin pakënaqësinë, por e shfaqnin në mënyrë spontane. Andaj, ishte e nevojshme me punua më tepër me ta. Dhe detyra e anëtarëve të organizatës, nga e tërë kjo delte se ishte primare: “Ti ndihmojmë punëtorët në luftën e tyre ekonomike, ta lidhim ngushtë këtë luftë me luftën politike, t’i sqarojmë punëtorët për qëllimin kryesor dhe detyrat politike të lëvizjes në përgjithësi, t’i orientojmë ata, të marrin pjesë dhe tu ndihmojmë në formulimin e kërkesave, në botimin e trakteve të agjitacionit dhe të përhapim sa më shumë literaturë të nevojshme ilegale te punëtorët. Ky agjitacion, kjo propagandë zgjon ndërgjegjen e tyre, i edukon dhe i organizon ata”⁵⁰, mendon autori i shkrimit.

Një punë tjetër mjaftë e rëndësishme që i priste anëtarët e saj, ishte edhe puna organizative me fshatarësinë dhe me shtresat tjera të gjëra siç ishin studentet, nxënësit e shkollave të mesme, intelektualet, zejtarët etj. Angazhimi i i anëtarëve të organizatës me fshatarët gjatë punës së tyre u tregua mase i domosdoshëm, për këtë bashkëpunim të ndërsjellë në tekst thuhej: “Se fshataret paraqesin forcën kolosale në luftë për çlirim. Ajo nuk është aspak indiferente ndaj kësaj lufte. Duhet ditur prekur plagët e fshatarit, dhe shtrohet pyetja athua fshatari i jonë a nuk ka plagë? Edhe mbi kurrizin e tij peshon shtypja dhe robëria me gjithë forcën e saj. Në çdo fshat shqiptar në Kosovë ka të mjerë, ka shtypje, ka varfëri, ka plagë kurbeti, ka mungesë të nevojave elementare të jetës, ka mungesë të shkollave, mungesë të rrugëve, mungesë të ndihmësve mjekësor etj, etj... Të njëjtën lojë e luajnë edhe ata, duke u munduar që ti përfitojnë fshataret, por ne nuk guxojmë ti lejojmë ata që të manipulohen dhe me punën tonë të vazhdueshme duhet ti demaskojmë armiqtë dhe t’iu tregojmë se kush janë ata dhe çfarë qëllimi kanë”⁵¹, me këtë dëshmon autori se mobilizimi i ilegales kishte arritur rezultate të lakmueshme në mesin e popullatës..

Veprimtaria propaganduese dhe agjitacioni thoshin anëtarët e organizatës, nuk duhet zgjedhur mjete dhe vend.. Për këtë duhet të shfrytëzohet, propozonin në gazetë, edhe ndejat në oda, tubimet e ndryshme, si dhe takimet e rastit me popullatën. Por gjithmonë duke pasur kujdes ndaj provokatorëve, pasi se ata ishin të kamufluar. Gjatë

⁵⁰ “ Çështje agjitacioni dhe propagandë”, gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f. 6.

⁵¹ Po aty, f. 8.

bisedave u këshillonte që anëtarët e tyre, duhej të ishin të matur, dhe të flasin me gjuhën e popullit, thjeshtë, qartë, kuptueshëm dhe bindshëm, që kësaj këshille ishte obligim që ti përmbaheshin me përpikëri të gjithë anëtarët e ilegales.

Ndërsa me rinin studentore, kishin kujdes më të shtuar, këtyre iu shpërndanin kryesisht material agjitacioni politik. U angazhonin në luftën për përmirësimin e kushteve të jetës e të shkollimit, në bojkotimet që organizonin ata dhe në kërkesat e tyre që ishin të drejta etj. Dhe detyrë tjetër e ilegales ishte që çdo ditë të thellojnë format e agjitacionit dhe propagandës, të hulumtojnë format e organizimit të tyre, ti perfeksionojnë ato, të përmirësojnë cilësinë dhe ti ngrejë ato nga një agjitacion i pjesshëm me kërkesa të vogla dhe të veruara në një agjitacion për të gjitha kërkesat kombëtare në tërësi.

3. Shqetësimet e organizatës për arsimimin shqip në Kosovë

Shtypi ilegal i viteve të shtatëdhjeta i kushtonte rëndësi të madhe arsimimit të popullatës shqiptare në vend. “Zëri i Kosovës” në numrin e saj të dytë, në rubrikën të titulluar “Plagët tona”, në tri faqe A-4, në mënyrë të argumentuar shtjellon çështjet arsimore dhe të arsimit shqip në Kosovë dhe të trojeve tjera shqiptare në ish- Jugosllavi.

Autori “Çlirim Bardhi” (Mustafë Ademi), në shkrimin e tij “Arsimi në Kosovë”, paraqet të dhënat, se okupatori ishte i vetëdijshëm se arsimimi i popullit zgjon ndjenjat nacionale tek ata, dhe se kjo paraqet rrezikun primar për regjimin. Andaj, politika e krerëve të Beogradit për mbajtjen e popullit në errësirën e prapambetjes dhe analfabetizmit, si dhe shtypja e egër gjeti shprehjen e saj në kuptimin e plotë armiqësor në krahinat shqiptare nën robërinë jugosllave dhe shovinizmin serbomadh.

Gjendja arsimore e popullit të Kosovës së robëruar nga Jugosllavia e krajlëve, ndryshon fare pak nën robëruesit e rinj. Pas çlirimit, në Kosovë u hapën shumë pak shkolla në krahasim me vendet e tjera jugosllave. Edhe ato që u hapën, u bënë me një qëllim të vetëm, sa për tu mburrur para botës se ja si i gëzojnë të drejtat pakicat në Jugosllavi, dhe se si populli shqiptarë shkollohet në gjuhën amnore . Është e vërtetë se populli shqiptar kishte dëshirë që të shkollohej. Ai e donte dijen dhe donte që populli të ngrihej në një nivel më të lartë të arsimimit, andaj i dhembte ajo që shumë nga ata ngelnin pa u shkolluar për hir të kushteve shumë të dobëta që ofronte sistemi okupes. Dhe duke u nisur nga këto të dhëna, autori me një zgjuarsis, ato i klasifikonte në disa pika, siç ishin:

E para, shteti i “ri “ jugosllav hapi vetëm disa shkolla në Krahinë të cilat ishte e pamundur të përfshinin të gjithë fëmijët që paraqiteshin për tu regjistruar në to, ku mësimi kryesisht zhvillohej në oda të ngushta të fshatarëve që ishin të ndërtuara prej balte dhe drunjve të dobët që shpeshherë paraqiteshin rrezik për fëmijë, dhe kryesisht mësimi zhvillohej në dy - tre turne. Nxënësit ishin të detyruar të udhëtonin me kilometra

të tëra gjerë në fshatin tjetër për të ndjekur mësimin⁵². Andaj, kur të kihen të tëra këto para sysh, ishte krejt e natyrshme që fëmijët të ndërpriteshin shkollimin e mos të flasim për fëmijët - femra që duhej të shkolloheshin. Por, herë- herë në mos vijimin e shkollimit të femrave ndikonte edhe propaganda e organizuar nga vetë pushtetarët për gjëja se “shkollimi e ç’nderon vajzën shqiptare”, ku një rol shumë negativ e luajti edhe kleri, një pjesë e të cilit ishte mjaftë injorante.

E dyta - fshatari kosovar duke qenë i varfër dhe i rraskapitur nga puna e tepërt dhe robëria, mezi priste që ti rritën pak të bijtë për të punuar, për të siguruar kafshatën e gojës. Për këta fshatarë, të shumtën e herës ka vetëm dy rrugë: ose ta shesë atë pakë tokë (nëse ka dhe gjënë e gjallë për të paguar shkollimin e fëmijëve të tij dhe anëtarët tjerë të familjes të ngelin edhe pa bukën e gojës, ose tua ndërpres atyre shkollimin për ti dhënë në punë, për sigurimin e bukës. Ata, me dashje o pa dashje shtrëngoheshin të zgjidhnin këtë të dytën. Kështu shumë të rinj detyrohen të ndahen nga shkolla që të shiten si argat të lirë te pasanikët e vendit⁵³, në republikat tjera të Jugosllavisë ose të marrin botën në sy.

E treta - Prapambeturija dhe konzervativizmi i fshatarit kosovar, ka ndikuar që gruaja kosovare ka ngelur e pashkolluar. Vajzat shqiptare në Kosovë, ose nuk fillonin fare shkollimin, ose të ndërpresin atë, për shkaqet e shënuara më lartë. Janë raste të pakta, ato që vijojnë shkollimin në shkolla të mesme e të larta.

E katërta - degjenerimi, është njëra ndër dukurit negative që i ka zënë shumë të rinj tanë, madje edhe të mitur, të cilët kanë qenë të ç’orientuar dhe të çoroditur. Lënë çdo ditë librat dhe shkollën për tu kthyer në rrugaçë, huligan, narkoman e prostituta, për ti mbushur burgjet delikuent e kriminelë, shqetësohen për këtë dukuri ilegalja shqiptare, duke pasur vazhdimisht kujdes që të ç’rrenjosin atë nga rinia e jonë e vyeshme⁵⁴.

Duke njohur këto, e shumë shkaqe tjera. Duke njohur politikën e kursin antishqiptar të Beogradit, të reaksionit të hapur dhe të shtypjes së egër, na del e evidencuar dhe shumë e njohur se numri i analfabetëve, që u priste që numri i tyre të zvogëlohej, ndodhte e kundërta, se numri i analfabetëve sa vije e rritej. Kështu, duke u mbështetur në të dhënat statistikore që e jepte shtypi zyrtar (nëse është për ti besuar), në vitin shkollor 1955 në klasën e parë janë regjistruar 31.642 nxënës dhe prej tyre klasën e tetë në vitin 1962/63 e kanë mbaruar vetëm 9.188 veta⁵⁵.

Sa për shkolla të mesme, ai dihet se ishte edhe shumë herë më i vogël. Kjo është një dëshmi që fletë qartë për të gjitha ato që u thanë më lart. Këtu duhet theksuar edhe një fakt se 12% të fëmijëve të përgjithshëm, të moshës 7-14 vjeçare mbesin pa u përfshirë fare në shkollat fillore. Këta pra, edhe mund të thuhej lirshëm se ishin ushtarët e

⁵² Po aty.

⁵³ Po aty.

⁵⁴ “Plagët tona”, gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974.

⁵⁵ Zëri i Kosovës, nr. 2, 1974, Arsimi në Kosovë.

ardhshëm të analfabetizmit kosovar (numri i saktë i analfabetëve në Kosovë nuk dihet, por u konsideronte të kishte qenë analfabete gjysma e popullsisë shqiptare).

Më kot shkruanin dhe trumbetonin funksionaret e Beogradit dhe bashkëpunëtorët e tyre, kur thoshin se në Jugosllavi ka “barazi nacionale”, dhe me të madhe thoshin se “po punohej për zhdukjen e diferencave në çdo fushë në mes kombeve, në mes të kombësive, krahinave dhe republikave” etj..., por ata, prapë detyrohen ti pohojnë vetë, diferencat e mëdha që ekzistonin në çdo fushë, pra, edhe në arsim. Të dhënat statistikore të shënuara më poshtë janë të marruara nga shtypi jugosllav që dëshmojnë të kundërtën e informimit. Në vazhdim po e bëjmë prezantimin e një tablele që pasqyron të dhënat e përfshirjes së nxënësve në shkolla fillore, të mesme dhe fakultete në ish-republikën e Sllovenisë, të Malit të Zi dhe të Kosovës:

Shkolla	Me sh. Fillore		Me sh. të mesme		Me fakultet	
	1953	1971	1953	1971	1953	1971
Vitet	1953	1971	1953	1971	1953	1971
Sllovenia	4,5%	30,8%	11,1%	23,4%	0,8%	3,2%
Mali i Zi	5,7%	15,4%	5,3%	14,0%	0,5%	2,4%
Kosova	1,9%	15,2%	2,3%	7,4%	0,1%	1,7%

Këto janë shifrat me të cilat u mburrehin pushtetarët për arsimimin e popullit kosovar. “Por, ne do tu thoshim atyre ti lënë këto shifra, të mos mburren me to se janë shumë të vogla dhe ti marrin tjerat, shifrat që flasin për efektin e degjenerimit tek të rinjtë dhe fëmijët shkollarë për të cilin revizionistët janë angazhuar më shumë dhe kanë pasur e kanë kujdesie të posaçme. Le të flasin për delinkuentët, për vjedhjet e krimet që bëjnë ata dhe le të mburren para kolegëve të tyre”⁵⁶ informon i mllëfosur me të drejtë shtypi ilegal opinionin e gjerë.

Në vitin 1966, 1101 jomadhur kryen 1856 vepra penale, kurse në vitin 1969 kjo shifër u rrit edhe më shumë, 2437 jomadhurë kryen 3561 vepra penale. Ndërkaq gjatë vitit 1971 vetëm në qytetin e Mitrovicës (Kosovë) kryen vepra penale 1029 fëmijë, dhe këto të dhëna për fëmijët tanë alarmonin kumbueshëm tek çdo shqiptar që i donte të mirën këtij populli edhe ashtu të shumëvujtur.

Këto shifra nuk pasqyrojnë gjendjen e vërtet e reale, pasi që për çdo vit mbetet një numër i madh i veprave të pazbuluara. Zaten kjo është “kujdesia e partisë” e “shtetit komunist” jugosllavë për fëmijët, për brezin e ardhëm, për popullin shqiptar, për Kosovën.

⁵⁶ “Arsimi në Kosovë”, gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974

“E klika titiste mund të bëjë për vete ca tradhtarë në Kosovë, mund ti dezorientojë e degjenerojë një pakicë të rinjve kosovar, mund të mbajë edhe ndonjë ditë popullin shqiptarë të Kosovës në errësirë, por kurrë nuk do të mund ta shuaj shpirtin e tij revolucionar, ai do të ngitet një ditë me gjithë fuqinë e tij dhe do të shoh dritën e vërtetë, dritën e lirisë që iu grabitë me të pabesë”⁵⁷ pohonte autori i shkrimit..

Në shtypin ilegal rëndësi e veçanet iu kushtonte rinisë, si asaj fshatare, asaj shkollore dhe asaj studentore. Dhe ardhmërinë e ndryshimeve politike, e shihnin te përkrahja dhe mbështetja e saj e madhe. Së tepërmi u brengosnin ata për fatin e saj dhe kishin frikë nga okupuesi mos do ta degjenerojë atë. Andaj në shtypin ilegal në çdo numër vend meritore zinin shkrimet e ndryshme, që kishin për qëllim edukimin, qëndrueshmërinë, shkollimin, dashurin ndaj atdheut dhe për shumë gjëra tjera, që ishin shumë të rëndësishme për edukimin e saj.

Në numrin e dytë të revistës “Zëri i Kosovës” gjendej edhe shkrimi “Përpjekjet e reaksionarëve jugosllav për degjenerimin e rinisë së Kosovës - do dështojnë me turp” e shkruar nga “Hysë Derveni” (Hydajet Hyseni).

Në fillim të shkrimit, autori cekte se sa e rëndësishme është rinia për një popull, e aq më tepër kur dihej për rinin tonë shqiptare se nëpër çfarë peripecish kalonin dhe se me çfarë presionesh duhet përballuar. Dhe shton “Hysë Derveni” se “Rinia është mbështetja më e fortë e popullit, shpresa e tij më e mirë. Rinia është ajo forcë që e lëvizë shoqërinë, që e shpije atë përpara”⁵⁸. Me të drejtë atë e kanë quajtur “lokomotivë të shoqërisë”. Por nga ana, pushtetarët mendonin se ajo ishte pengesa më e vështirë në realizimin e qëllimeve të arrta të qarqeve okupuese. Nisur nga fakti se “aty ku është rreziku më i madh, aty edhe është lufta kryesore”, “mund të kuptohet qartë”,⁵⁹ thotë autori, se pse bëhet aq luftë dhe përpjekje për ta paralizuar dhe për të paaftësuar rininë, se ata (okupuesit), llogarisin në pasojat astronomike.

Autori bënë një elaborim të mirë e të thukët, kur fletë për angazhimin e shtetit se si ta “kombëtarizojë rinin kosovare (shqiptare)”. Në këtë luftë armiku nuk zgjedhë mjetet e as mënyrat duke filluar që nga ato më primitivet të shtypjes dhe terrorit e gjerë te arma më e re dhe më “moderne”- degjenerimin e rinisë, e cila armë po përdorët me të madhe edhe në vendet tjera të Jugosllavisë, ku rinia paraqet shenja të pakënaqësisë

“Kjo luftë për bashkimin kombëtar për Kosovën nuk është e re dhe e panjohur”, vazhdon autori, por jo dhe e papritur. “Kosova është e mësuar me lufta. Qysh pas luftërave ballkanike kur Kosova ra nën kthetrën e shovinistëve të Jugosllavisë, kundër Kosovës filloi lufta për ç’kombëtarizimin e popullsisë shqiptare e cila gjithmonë

⁵⁷ Po aty, f. 17.

⁵⁸ “Përpjekjet e reaksionarëve jugosllavë për degjenerimin e rinisë së Kosovës- do dështojnë me turp”, revista “Zëri i Kosovës” nr. 2, 1974, f. 19.

⁵⁹ Po aty, f. 20.

shoqërohej me diskriminimin kombëtar, torturat më të egra që mbanë në mend historia. Luftërat hegjemoniste nuk pushuan kurrë, ajo në forma dhe mënyra të ndryshme po vazhdon edhe sot. Këtë luftë reaksioni po e bënë në çdo mënyrë bile shumë herë krejt haptas”⁶⁰, e thotë autori i shkrimit.

Për të shkruar për deformimet që i bënte me qëllim sistemi jugosllavë, nuk ishte shumë e nevojshme të lexojmë ndonjë literaturë të caktuar, ose të vejmë syza e të studiojmë gjatë për to, “mjafton të dalësh në rrugë dhe të shikosh rinin se si rrinë kotë së koti në rrugë, dhe imitojnë botën e perëndimit, me ca veshje të çoroditura dhe donë të imitojnë “hipikët”, ndërsa, me asgjë nuk ngjasojnë në perëndimin, dhe nuk e din pse janë të këtillë”,⁶¹ vije në përfundim autori.

Alkoolizmi si dukuri negative shqetësonte pa masë anëtarët e grupit. Andaj në shtypin e tyre nuk mungonin trajtimet nga më të ndryshmet. Frika se alkoolizmi dita më ditë po e përfshin me të madhe rinin tonë, e alarmonte ilegalen. “Kafenetë janë gjithherë plot me të rinj, dhe kohën më të madhe e kalojnë duke pirë e që nuk e din pse pinë”⁶², frika nga ndeshtrashat që i kishin zënë pritën rinisë ishte trajtim permanent në revistën “Zëri i Kosovës”, dhe për këtë dukuri nuk hezitonin fare që të shkruanin në çdo numër.

“Kriminaliteti” ishte dukuri që iu mveshte rinisë shqiptare. “Vrasjet”, “vjedhjet”, “mashtrimet”, “dhunimet” e çka nuk pollte mendja e udbashëve pothuajse ishin bërë akuzime të përditshme për rininë. Rinia ishte e dëshpëruar ngase e kishin kuptuar se kishte ngelur në mëshirën e njerëzve që nuk ia donin të mirën rinisë së shëndosh shqiptare.

Për të gjitha këto dukuri që u shfaqnin në shoqërinë tonë, askush nuk ishte fajtor veç pushtetit jugosllav e cila vazhdimisht thirret në atë, se të tëra këto që po shfaqen, po shfaqën aq papritmas, dhe se ajo është e angazhuar me të madhe për zhdukjen dhe çrrënjosjen e tyre, ndërsa e vërteta qëndronte ndryshe dhe për këtë shkruante me të madhe shtypi ilegal. Se pushtetarëve iu konvenonte një kaos i tillë te të rinjtë ishte mase evidente. E vërteta ishte tjetër fare, e tërë kjo ishte një lojë e qëllim të sidomos kjo kur shpifej për rinin shqiptare. Dhe përfundon autori se “atë që nuk kanë mundur ta mbërrijnë me tortura e forcë, po mundohen ta mbërrijnë me një mënyrë tjetër akoma më të rrezikshme, që ta degjenerojnë rininë, ta paaftësojnë, ta largojnë atë prej rrugës së lirisë, ti shuajnë asaj dashurinë ndaj atdheut dhe kombit dhe në këtë mënyrë ta bëjnë atë që e kanë ëndërruar që moti- ta zhdukin emrin Kosovë”,⁶³.

Në shkrimin e lartpërmendur, autori porositi se “një gjë duhet ta dinë revizionistët - shovinistët jugosllav, se në truallin e Bajram Currit e Ali Kelmendit, te Asim Vokshit e

⁶⁰ Po aty, f. 21.

⁶¹ Gazeta e Organizatës ilegale “Grupi Revolucionar”, “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f. 23.

⁶² Po aty.

⁶³ “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f. 32.

Emin Durakut-nuk shuhen traditat e larta patriotike e revolucionare...”⁶⁴ në fund e përmyllë shkrimin me optimizëm autori.

Në bazë të shkrimeve që prezantohen në revistë, vijnë në përfundim se autorët janë të drejtpërdrejt dhe gjërat quhen me emrin e vërtetë të tyre. Andaj shtypi ilegal, nga masat e gjëra ishte shumë i kërkuar për lexim, por nuk mungonte edhe hulumtimi i shtuar i UDB-ashve për ti ra në gjurmë artikullshkruesve

Populli shqiptar megjithëse ishte i kalitur dhe i brumosur me luftëra dhe atdhetari me shekuj, dhe i ka rezistuar sulmeve të egra të armiqve, nuk mund të gënjehej dhe mashtrohej kurrë më me njëfarë demagogjie e manovre të reaksionarëve jugosllavë. Armiqtë e popullit shqiptarë u gënjenin keq se ata pa marrë parasysh se çfarë lloj metode përdornin, kurrë nuk do të mundnin ta shuanin dashurinë ndaj atdheut dhe kombit. Edhe ata më në fund e kuptuan se e kanë kotë se edhe kjo manovër e tyre dinake- po dështonte me turp. Nuk kishte forcë që mundte ta ndante ata nga këto mësimë dhe nga qëllimet e tyre të larta dhe të shenjta-Liria ,të cilën sa e sa herë e kemi paguar dhe do ta paguajmë me gjak.

Veç problemeve tematike që përfshihen në gazetë, autor të ndryshëm paraqiten edhe me vështrime për libra të caktuar siç është rasti i “Bashkim Gollakut” (Kadri Osmani) që prezantohet me recensionin për librin e Vlladimir Dedierit “Marrëdhëniet jugosllavo-shqiptare (1939- 1948)” që kishte botuar shtëpia botuese “Prosveta”, Beograd 1949. Në këtë vështrim, që ishte i titulluar “Politika revolucionare shqiptare-po e çanë si me shpatë propagandën revizioniste jugosllave”, ndër të tjera autori shkruan se “Biografi i Titos, Vladimir Dedijeri, që më 1949 nxitoi ti publikojë marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave dhe në librin e tij prej 250 faqesh grumbulloi material nga arshivat e ndryshme por me “faktet” dhe “argumentet e “pamohueshme” shpesh bie në kundërshtim me vetveten. Ai me anën e këtij libri deshë ta bind opinionin e gjorë të brendshëm dhe të jashtëm se gjëja Jugosllavia dhe PKJ-ja ishte ajo që i ndihmuan dhe e çliruan Shqipërinë nga kthetrat nazi-fashiste”.⁶⁵

“Që në faqen e 11, biografi i diktatorit” shkruan autori “se Dushan Mugosha-Duqi (Sali Murati) me të arrirë në Tiranë e merr lidhjen me disa grupe, por përfaqësuesit e grupit të “Korçës” nuk patën besim të flasin me të sepse nuk kanë pas kurrfarë certifikate se jam komunist. Në lidhje me këtë unë jam tallë tu fol se komunistët jugosllavë akoma nuk janë të vulosur, (shkruan Dushan Mugosha, shënim i SK-B)”⁶⁶, komenton autori i shkrimit.

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ “Politika revolucionare shqiptare po e pretë si me shpatë propagandën revizioniste jugosllave”, revista “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974.

⁶⁶ Po aty, f. 9.

Në lidhje me formimin e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare ai citon: “Por, këtë nuk e kuptuan disa anëtarë të KQ të PKSH, në mes të të cilëve ka qenë edhe Enver Hoxha dhe Dr. Ymer Dishnica, kjo për arsye të papjekurisë politike dhe pse ishin të pa perspektivë”. Por “ me propozimin e Dushan Mugoshës në Kongresin e Përmetit, në mbarim të vitit 1944, Enver Hoxha u emërua për komandant të Shtabit të Përgjithshëm me gradë gjeneral- kolonel”, thekson autori fjalët e Vlladimir Dedijerit⁶⁷..

Kurse gazeta “Borba”, që botohej në Beograd, në kryeartikullin e saj më 8 janar 1945 shkruante: “Populli fisnik shqiptar, u çlirua i pari në të gjithë kompleksin e luftës së aleatëve, vetëm me forcat e veta dhe i pari ka qenë në Evropë i cili është përgjigj me armë kur fashistët zaptues shkelën tokën e tij në prill të vitit 1939, dhe nga kjo që thotë gazeta “Borba”, vijmë në përfundim se edhe kur nuk paskan arrit instruktorët e Beogradit siç ishin: Duqi, Svetozar Vukmanoviq- Tempo dhe Bllazha Jovanoviqi, shqiptaret paskan ditur të dalin në mal dhe të luftojnë për lirinë e tyre⁶⁸. Atëherë autori i këtij shkrimi në revistën “ Zëri i Kosovës “, me të drejtë bënë pyetjen:”Atëherë kush kë e çliroi?!”

Në shkrimet që hasën në shtypin jugosllavë, një ditë më vonë, “diktatori jugosllav me 9 gusht 1945 deklaroi:” vendi i rrënuam nga okupatori dhe populli shqiptar i varfënuem, për sakrificat dhe kontributin në luftë meriton simpatitë më të nalta dhe çdo ndihmë që popujtë tonë mundë ti japin, dhe kjo më tepër, sepse disa njësi shqiptare pas çlirimit të Shqipërisë u bashkuan me ushtrinë tonë dhe s’bashku luftuan për përzanjen e okupatorit nga Mali i Zi dhe Sanxhaku...”⁶⁹, Ndërsa Millovan Gjillasi thot se “Sjellja e ushtrisë Shqiptare në Jugosllavi ka qenë e jashtëzakonshme dhe ajo, në pikëpamje ushtarake, jo vetëm se e ka kryer detyrën e besume por ka tregua iniciativë dhe vetëmohim në luftë për çlirimin e Jugosllavisë sikur të luftonte për vendin e vetë”⁷⁰ na njofton autori.

Dhe në “Epilog” të librit shkruan autori se, Vladimir Dedijeri shkruan “botimi i këtij publikimi përfaqëson nga ana jugosllave përpjekjen e parë që publikisht ti paraqiten publikut tonë dhe të jashtëm marrëdhëniet jugosllave-shqiptare për këto tetë vjet të kalume në mënyrë më të plotë”, për të vazhduar se ”mund të gjykojë, në radhë të parë, vetë populli shqiptar, i cili këtë ndihmë vëllazërore të gjanë e ka ndijë në ditët më të vështira dhe më vendimtare në historinë e tij”⁷¹, dhe me të gjitha këto të thëna, Dedijeri, shpesh bije ndeshë me fjalët e veta dhe mundohet vazhdimisht të fshehë të vërtetën si nga opinioni i gjerë vendor, po ashtu edhe nga ai ndërkombëtarë⁷².

⁶⁷ Rubrika “Vështime”, “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f.10.

⁶⁸ Po aty.

⁶⁹ Po aty, f. 11.

⁷⁰ Po aty, f. 12.

⁷¹ Po aty.

⁷² Po aty.

Në libër gjerë e gjatë jepen të dhëna që fare nuk përkojnë me realitetin, bile në një vend thuhej se “Shqiptaret vendosën për fatin e vet!!!”, kjo fjali me gjasë nuk do koment, pasi se me këtë fjali u manipulua dhe manipulohet edhe në ditët e sotme.

Me çfarë të drejte shkëputet një popull prej shtetit amë kur e përbëka shumicën më të madhe të popullsisë në Kosovë?! pyet “Bashkim Gollaku” E sa për borxhin prej 1 miliard e 700 milion dinar që e cek autori, artikullshkruesi thotë: “Populli shqiptarë do të llogaritet mirë e mirë se kush kujt i ka borxh. Premtimet demagogjike të diktatorit, pas shkëputjes definitive, edhe gjatë luftës, u shndërruan në aksion çkombëtarizimi dhe gjenocidi në masë”⁷³.

Në gazetë, në një rubrikë të veçantë shkruhet edhe për jetën dhe veprën e “Josip Visarionoviq Stalinit”, shkruar nga “Gjin Dukagjini” (Binak Ulaj).

Sikurse në numrin e kaluar mjaft vend i kushtohet poezisë. Në këtë numër prezantohen me poezi: “Bashkim Gollaku” (Kadri Osmani) me dy poezi: “Gjumi vigjilent” dhe “Qëndro Gollak”. Poezitë kanë karakter patriotik dhe me një mënyrë brilante prezanton dhe shtron në mënyrë sintetike dhe koncize problematikën e historisë së popullit shqiptar, problemet e identitetit të rrezikuar kombëtar. Kjo poezi nuk ka dyshim se është poezi e kujtesës, kujtesës kombëtare dhe e fatit historik. Autori nëpër mes të vargjeve bisedon me popullin se edhe në gjumë ky popull i stër-vuajtur është vigjilent. Ndërsa në poezinë “Qëndro Gollak”, i kushtohet Gollakut dhe popullsisë së saj, dhe jo vetëm atyre. Autori në poezinë e vet nuk shtron vetëm problemet e ekzistencës kombëtare, të realitetit të hidhur të kohës, por në këtë poezi shtrohen edhe probleme universale të ekzistencës të rëndësishme në luftë përball sistemeve totalitare për liri dhe demokraci. Nëpër mes kësaj poezie poeti i epë zemër popullit se: Kur rigon e fryn era/ edhe tufani si rrebesh/ kur ulurin ujku te dera/ mos u mrrol, as mos u qesh”⁷⁴. Poeti e di se populli, okupuesin e përjetonte në formë të ujkut, dhe qëndronte mbi çdo shtëpi dhe nga ai u kanoste rreziku, por lutet “Ah, qëndro Gollaku im/ Edhe tregoi botës mbarë/ E lësho zërin ep kushtrim/ Se ke fatosat atdhetarë”⁷⁵.

Në këtë numër “Lekë Kraja” (Mehmet Hajrizi) prezantohet me tregimin “Bashkimi i shokëve”, ku shtjellohet me një gjuhë-shpatë, lufta dhe qëndresa e shqiptarëve, por prezantohet edhe tradhtia si dukuri që paraqitet tek disa shqipfolës. Fjalët : populli, nderi, atdheu - nganjëherë bëhen si një sfond për të shprehur ndjenjat më sublime poetike. Me një mjeshtëri të rrallë paraqet se si bashkimi, aktiviteti i tyre, dashuria për vendin i bënë të pathyeshëm, dhe se si dhe në çfarë gjendje e pësojnë tradhtarët, ata që punojnë për interes të armikut. Zejna ishte njëri prej tyre që i tradhtonte shokët, dhe bartte informata për aktivitetin e tyre, për ca para të fëlliqura që i epnin

⁷³ Rubrika “ Vështrime “, gazeta “ Zëri i Kosovës “, nr. 2, 1974, f. 13.

⁷⁴ “ Qëndro Gollak “, gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974.

⁷⁵ Rubrika “Këndi i poezisë”, gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974.

spiunet e Lubishës. Dhe kjo është kështu, pasi se dihej çka e pretë tradhtarin, “edhe plumbi në ca momente është pakë për të”,⁷⁶ thotë Lekë Kraja.

“Hysë Derveni” (Hydajet Hyseni) në poezinë “Simbol i lirisë dhe bashkimit kombëtar” paraqet luftën e popullit shqiptarë për liri dhe bashkim kombëtar, e kjo ishte gjakim i shumë gjeneratave. Poezia i kushtohet simbolit të luftës dhe të rezistencës, prijësit të luftës dhe të qëndresës (Hasan Prishtina). Kisha shtuar se kjo poezi që shkruhet nga një veprimtar i ilegales ku toka kundërmon boje kafe, e ujitur kushedi sa herë me gjak. Me shekuj në atë tokë qëndrojnë kulla vrojtimi të vetmuara, ku dikur ishin vende mbrojtjeje, derisa më vonë u shndërruan në simbole të rezistencës dhe të qëndresës, të banuara nga shqiptarët, si shenja dalluese të identitetit në mbrojtje nga sulmet e jashtme, ku gjithnjë ai fatum rëndoi mbi popullin shqiptar. Imazhi i atdheut të copëtuar është si një lajtmotiv⁷⁷ në poezitë dhe shkrimet e autorëve që i përkisnin ilegales shqiptare: “Shkrove faqet më të ndritura të historisë/ Ti viga i Kosovës e i tërë Shqipërisë/ I popullit prijës strateg e luftëtar/ Në zemrat tona prore dhe çon ato peshë/ Ëndrra e jote do bëhet realitet e ti do jesh/ Simbol i lirisë dhe i bashkimit kombëtar”⁷⁸ shkruan autori herë- herë në valë dëshpërimi, e herë- herë në valë gëzimi e optimizmi.

Në vazhdim të gazetës bëhet prezantimi i rubrikës “skicë”, në të cilën autori me nistoret “Bashkim Gollaku” (Kadri Osmani), paraqet shkrimin “Banesa për punëtorët”. Në pika të shkurtra përshkruhet jeta e vështirë e punëtorëve, që jetojnë në varfëri të skajshme, pa banesa, pa kushte elementare për jetë. Ndërsa Kosova në anën tjetër është e pasur me xehe, me fusha pjellore, me male dhe me çka jo tjetër. Por, populli i saj edhe më tej përpëlitej dhe jeton në skamje. Autori shtron pyetjen se çfarë duhet të bënte popullata? Duhet të mos i besoj propagandës, atë që e thotë edhe trakti që e gjejnë ata në minierë “Punëtorë, mos i besoni propagandës së armikut! As gazetave e as radios e televizionit. A nuk u ngopëm qe 30 vjet me demagogji revizioniste? Vetëm revolucioni i shëron plagët tona...”⁷⁹ ishte konkludimi i autorit.

Veç shkrimeve që vinin nga autorët nga vendi, revistës i vinin edhe letra të ndryshme nga jashtë nga mërgimtarët tanë që ishin të punësuar në vendet perëndimore. Në këtë numër (II), botohet letra e një mërgimtari që vinte nga Amerika e largët dhe letra fillon me një shprehje mallëngjyese:

”Të dashur vëllezër!

Me të drejtë thonë se s’ka vdekje më të vështirë se të vdesësh për së gjalli. Kështu mund të them për ne dhe jetën tonë prej se shkelëm në këtë të mallkuar Amerikë. Po

⁷⁶ Tregimi “ Bashkimi i shokëve “, gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974.

⁷⁷ Ewa Smietanska, fjalë rasti në promovimin e antologjisë së poezisë shqipe në polonisht “ Nuk është vonë për dashuri”, e poetit Mazllum Saneja, Ymer Berisha “Poezi e kujtesës, e fatit historik”, “Koha ditore”, 2 korrik 2005.

⁷⁸ Poezia “Simbol i lirisë dhe i bashkimit kombëtar”, gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f. 34.

⁷⁹ Rubrika “ Skica”, “ Banesa për punëtor”, gazeta “Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f. 40.

vëlla. Nuk ka ditë as natë të mos qaj për fatin e zi që na gjet. Tani po e shoh pse na fton me aq bujë Xhela, ku paska qenë qëllimi i tij dhe pse na fliste për këtë “parajsë”. Tani po e di edhe pse ata të hyqmetit për pak kohë na i epshin dokumentet aq shpejt sa s’më besohej. Po, qëllimi i tyre paska qenë që ti lëshojmë truallin ...” dhe më vonë vazhdon “Andaj vëllezër , amanet mos e mësyni këtë të mallkuar. Mos ia ktheni shpinën atij trualli mos e fikni atë zjarr në vatër, mos e shkretoni atë tokë se ne te ruhen eshtrat dhe gjaku i të parëve tanë. Dine se ai i cili thotë të vini këtu, është armiku ynë, andaj qoftë i mallkuar!

Ju përshëndesim vëllazërisht duke ju thënë: Mos paçi fatin tonë!⁸⁰ - përfundon letrën mërgimtari shqiptar.

Në raste të shumta kjo letër mund të përdoret si një dokument dhe dëshmi e tragjedisë e e dëshpërimit të mërgimtarit që kishte qenë i detyruar për të lëshuar trojet e të parëve për hir të dhunës, skamjes dhe mjerimit që mbretëronte në vend. Kjo dukuri e dhembshme kishte vazhduar edhe më vonë sidomos pas viteve të ‘90 kur presioni e terrori dukshëm u shtuan nga okupuesi.

Gazeta mbyllet me “Këndin satirik” e cila i kushtohet “Udhëtimi i Titos në Indonezi” shkruar nga “P. Shkreli” (autor nga Shqipëria-marrë nga një përmbledhje të poezive të tij satirike). Nga natyra e vetë ngjarjeve dhe e vetë fatit historik gjejmë në këtë poezi ngjarje që shtrojnë ironinë dhe dramën e popullit , në të cilën bien dhe rrënohen vlerat etike-morale. Autori me një humor të stërholluar vë në spikamë të metat dhe dobësitë e Titos, dhe klanit që e rrethonte. Në mënyrë të spikatur vë në pah vetit e tija prej hipokriti dhe gllabëruesi të pa masë të tokave të huaja.

Pas Plenumit të Brioneve (1966), dhe demonstratave të vitit 1968, në Kosovë, pati një dendësi të ngjarjeve politike që dëshmojnë për një arritje të konsiderueshme të legales dhe ilegales shqiptare. Edhe pas këtyre ngjarjeve të rëndësishme, populli shqiptar ishte i pakënaqur, ngase nuk iu realizuan dhe nuk iu plotësuan kërkesat e tyre jetike. Anëtarët e “Grupit Revolucionar, vitin 1974, e quajnë të rëndësishëm, ngase po në këtë vit filloi të dalë edhe revista ilegale e organizatës“ me emrin “Zëri i Kosovës”, që njëherë ishte edhe organi kryesor informativë i saj. Është karakteristikë se edhe në këto vite të okupimit jugosllavë, që Kosova kishte ngelur pa dashjen e saj nën Jugosllavi, vlen të ceket se në këto vite me të madhe ishte gjallëruar aktiviteti ilegal, dhe si detyrë parësore edhe më tutje kishte bashkimin e Kosovës me Shqipërinë dhe luftën e pa kompromis kundër okupuesit.

Gazeta “Zëri i Kosovës”, doli në rreth dhjetë numra, por janë ruajtur vetëm dy. Ajo trajtoi tematika dhe problematika nga më të ndryshmet. Në të gjitha ato rubrika të

⁸⁰ Rubrika “ Letra e një mërgimtari” , gazeta “ Zëri i Kosovës”, nr. 2, 1974, f. 35.

larmishme informative, problemore, paksa edhe letrare-satirike paraqiti në mënyrë të sinqertë situatën reale e të rëndë të Kosovës e të popullit të saj.

“Zëri i Kosovës” gati në të gjitha shkrimet, demaskonte okupatorin, dhe luftën e pa kompromis të popullit të saj për liri e pavarësi. Si kriter bazë në gjykimet e veta ky organ kishte vu shkëputjen, bashkimin me shtetin amë. Një fuqi befasuese dominonte në tërë shkrimet e revistës, por dallon dukshme nga shtypi ilegal i mëhershëm që u botua në Kosovë. Në këta dy numra bie në sy një trajtim paksa i ndryshueshëm. Temat me tematika të drejtpërdrejta të nxjerra nga vetë përditshmëria e jetës, dhe vetë angazhimi i autorëve, ato s,bashku lëvizin në disa drejtime të ndryshme, pra në më tepër se në një dimension : robëria e liria binome të pandara, dhuna e terrori karakterizojnë përsëri periudhën pasbrioniane, shtypja e mërgimi janë plagë që zënë vend të rëndësishëm në revistë, dhe në të shumtën e rasteve vetë mënyra e të shkruarit të dukej e “frikshme” dhe plot revolucionaritet. Lufta për liri, robëria, shtypja, korrupsioni, krimi, burgu, dhe vetë fati i pazgjdhur i atdheut e bëjnë gazetën më të plotë, më me diversitet dhe më nxitëse, që edhe sot e intrigon lexuesin për ta lexuar dhe analizuar gjerë në fund gazetën “ Zërin e Kosovës”.

Gazeta “Zëri i Kosovës”, lirshëm mund të thuhet se shënon vazhdimësinë e komunikimit ilegal që ishte krijuar e formësuar për vite të tëra në Kosovë, dhe vet gazeta është dëshmi e qenies dhe ekzistencës sonë, dëshmi e njohjes dhe rinjohjes, e qëndresës së përjetshme, e ecjes dhe e gjakimit të ëndrrës sonë nëpër kohë. Shkrimet në këtë gazetë, janë të thjeshta, të qarta. Janë shkrime të qëndrueshme, që në vete përmbajnë dashuri për atdheun dhe për lirin, por që nuk reshtëm së kërkuari në forma të ndryshme. Shkrimet e gazetës poçes lexohen me vëmendje na ofrojnë një vërtetësi thelbësore të kohës, dhe automatikisht këto shkrime shndërrohen në vlerë të qëndrueshme të të dhënave historike.

Prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha

GAZETA “ZËRI I KOSOVËS” DHE ROLI I SAJ PATRIOTIK

Rezyme

Si vazhdimësi e grupeve të mëhershme ilegale patriotike shqiptare në Kosovë ishte edhe Organizata patriotike ilegale “Grupi Revolucionar”, që u formua në vitin 1972. Në aktgjykimin e anëtarëve të grupit nuk thuhet se me cilën datë është formuar organizata, por, dihet me saktësi se organizata u formua nga patriotë të njohur të jetës ilegale. Grupi Revolucionar kishte formuar si pjesë të vetën organizative një komitet të studentëve në pranverën e vitit 1974 në përbërje: Xhafer Shatri- përgjegjës, dhe anëtarët Rexhep Malaj (zëvendës), Gani Sylaj, Hydajet Hyseni dhe Ilmi Ramadani. Grupi Marksist-Leninist i Kosovës (vazhdues i GRK), më 1978 kishte formuar përveç Komitetit Drejtues edhe Komitetin Ekzekutiv në përbërje: Ismail Sylja, Jakup Krasniqi, Saime Isufi,

Bejtullah Tahiri, Jashar Hajrizi, të gjithë këta me rastin e 100 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e shpërndan edhe një trakt. Qëllimi i organizatës ishte që në mënyrë të organizuar të punohej ilegalisht me masat e gjera, për të krijuar në të ardhmen një klimë të përshtatshme në të cilën do të mund të sendërtoheshin synimet shekullore që Kosova dhe pjesët shqiptare nën ish- Jugosllavi të bashkoheshin dhe në një të afërme të shpejtë të bëheshin pjesë e pandashme e shtetit amë-Shqipërisë. Për punë sa më të suksesshme ilegale dhe për të ruajtur konspiracionin e thellë të anëtarëve, udhëheqja e organizatës anëtarëve të vet u caktoi pseudonimet dhe punën e mëtejshme e organizuan në formë të “tresheve“. Ndërkohë përpiluan dhe shtypën “Paraprojektin” e organizatës ilegale. “Grupi Revolucionar“ veprimtarinë e vet e orienton drejt zgjerimit të radhëve- si kusht vendimtar për krijimin e partisë pararojë. Në punën e mëtejshme të anëtarëve të organizatës bie në sy sidomos veprimtaria botuese e saj. Duke pasur parasysh rrethanat historike në të cilën vepronin radhët ilegale dhe mungesën e përvojës së shtypit të Lëvizjes Kombëtare të Kosovës së pas LDB, ndërmarrja për një shtyp të tillë ishte sa e vështirë aq edhe e guximshme. Pas shumë diskutimeve në grup, ishte vendosur që organi i organizatës të quhej “Zëri i Kosovës”. Më 1974, grupi ilegal nxori numrin e parë të saj, të pagëzuar me emrin “Zëri i Kosovës”, ashtu edhe siç ishin marr vesh. Ilegalistët fillimisht mendonin se kjo gazetë njëherë do të jetë edhe zëri i vërtetë i popullit të Kosovës. Gazeta “Zëri i Kosovës”, numri i parë i saj doli me 1 shkurt 1974. Dhe fillimisht kishte 32 faqe, të shtypura në makinë në fletë A-4.

~~~~~  
 © Pashtriku.org, Tetor'2015  
 ~~~~~